



**MOS TË NA DEVIJOJË
FANATIZMI
NGA THELBI I FESË!**



**HAMZA KUÇI - NJË LUFTËTAR
I MADH KUR LUHEJ ME FATET
E KOMBIT DHE SHTETIT HQIPTAR**



**TË AFRUARIT E FËMIJËVE
ME XHAMINË**

UDHA ISLAME

Viti 18 - Nr. 1 (203), Janar, 2020

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIA SHKODER1990

**NUK I VJEN E KEQJA as popullit tonë,
as njerëzimit mbarë, NGA ISLAMI!**



“Kur isha në postin e Negociatorit të Lartë për Çështjet e Refugjatëve, pashë bujarinë e shteteve islame, të cilat hapën kufijtë e tyre për njerëzit e sprovuar, në një botë, ku për fat të keq, shumë kufij janë mbyllur!

Kjo përputhet edhe me atë, që e konsideroj si përshkrimi më i bukur që është thënë në lidhje me mbrojtjen e refugjatëve në historinë e njerëzimit.

Ajo që thuhet në suren “Teube”, ajeti 6, në Kur’anin e Shenjtë: “E nëse ndokush prej idhujtarëve të kërkon strehim,

ti strehoje në mënyrë që t’i dëgjojë fjalët e All-llahut (Kur’anin), e mandej përcille deri në vendin e tij të sigurt. Këtë, ngase ata janë popull që nuk e di (të vërtetën e fesë islame)”.

Ky ajet iu shpall të Dërguarit, paqja qoftë mbi të, para 14 shekujsh, para se të shpallej Konventa për Mbrojtjen e Refugjatëve në vitin 1951..!”

ANTONIO GUTERRES

(Sekretar i Përgjithshëm i OKB-së)

MYFTIU VIZITOI KRYETAREN E BASHKISË SHKODËR



KËSHILLI I MYFTINISË DISKUTOI MBI AKTIVITETET E VITIT JUBILAR 2020





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

MOS TË NA DEVIJOJË FANATIZMI NGA THELBI I FESË!

Nëse dikush të pyet se çfarë është Islami, lexoji atij ajetin 177 të sures El-Bekare! Por, a mund të përfshihet krejt feja në një ajet të vetëm? Si jo?! Ne po flasim për Librin e All-llahut të Madhëruar, nuk po flasim për libra njerëzor!

Ky ajet u shpall, si për të na mësuar deri në ditën e fundit të jetës mbi tokë se, çështja nuk është tek ana e jashtme e gjërave dhe fanatizmi i verbër që na lidh pas tyre, por tek thelbi!

Namazi është thelbi, jo drejtimi i kibles, që u urdhëruam ta ndryshojmë një herë e përgjithmonë dhe kështu do të jetë deri në kijamet!

Çfarë rëndësie ka numri i shkallëve të minberit? Hytbeja është thelbi, edhe nëse e ligjërojmë poshtë, para njerëzve! Nëse ulem tani edhe dy shkallë, a ulem krejt poshtë dhe vazhdoj të flas; hytbeja është thelbi, jo këmbët e shkallës së minberit!

Çfarë kuptimi ka të prishim harmoninë e xhamisë për gjëra sipërfaqësore dhe të humbim thelbin, siç ndodh rëndom në realitete dekadente!?

Të ruhemi për të mos e humbur esencën dhe thelbin e besimit, duke u kthyer tek vlerat e besimit dhe thelbi i tij, tek pyetja me vlerë, tek zhvillimi i mendimit, tek formimi i individit të shëndoshë, tek xhamia që e ruan të riun tonë për të mos u bërë i paedukatë dhe i pafytyrë, sidomos ndaj familjarëve të tij jopraktikantë të fesë!

Para ca kohësh, më ndali një zonjë e moshuar. M'u ankua për nipin e saj, që vinte në xhami. U habita? Përse të ankohej për nipin, frekuentues të xhamisë, xhanëm? Tha, me shumë dhembje se, zotëria e tij e ngrinte

zërin në shtëpi, i fyente, i trajtonte keq familjarët e tij që nuk faleshin e nuk ishin praktikantë!

Hasbijallah! Po cila xhami e mëson këtë? Cili Islam e udhëzon drejt shthurjes morale dhe mosrespektimit të prindit, edhe nëse është jobesimtar?

A nuk na tregoi Resulull-llahu (a.s.) për pijanecin, se ai e donte All-llahun dhe të Dërguarin e Tij? A nuk tha për personin, që i thanë se vidhte se, namazi do ta ndryshonte sjelljen e tij dhe ashtu ndodhi?!

Kaluan 30 vite dhe ne kemi nevojë për të lexuar drejtë e saktë Kur'anin dhe Fjalën e Resulull-llahut (a.s.)! Sepse ky Kur'an dhe Fjala e të Dërguarit të Tij kanë ardhur për të na nxjerrë nga errësira në dritë, për të na bërë njerëz fisnikë, njerëz me vlera, njerëz me dritë! Jo njerëz të izoluar, të mbyllur e të bunkerizuar! Jo njerëz në bodrume!

Ajeti kur'anor që kemi para duarve, është një mundësi e madhe për të kuptuar se sa e madhe dhe sa e gjerë është kjo fé e madhnueshme islame! Se sa hapësira të mëdha na jep feja në jetën tonë, për ta jetuar atë të shoqëruar me besim dhe me vlera!

(Nga hytbeja e xhumasë, e mbajtur, më 10 janar 2020, në xhaminë e Tophanës)

EDHE JOMUSLIMANËT I PRESIM ME BUKË E BESË!

Sa madhështor është ajeti 8 i sures El-Insan: "Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër". Mendo për pak dhe kupto se Islami e ka bërë mirësinë ndaj armikut (lexo: të zënëve robër më luftë), rrugë drejt xhennetit! Por, drejt xhennetit nuk shkohet pa zemër të pastër, që do të thotë se këtë mirësi ndaj tyre, All-llahu ia ka kërkuar që ta bëjnë me zemër të pastër e nijet të sinqertë!

ME DHANË DHE MOS ME PRITË! ME E USHQY ARMIKUN ME BUKË DHE MOS ME PRITË AS EDHE NJË FALËNDERIM PREJ TIJ! KJO ËSHTË PREJ MADHËSHTISË SË SHFAQJES SË MUSLIMANIT HAK!

Dhe këtë e vërteton ajeti pasues: "Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të All-llahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim!". Pra, çdo mirësi në këtë kontekst bazohet mbi sinqeritetin e nijetin e pastër, si dhe mosinteresimin për të pritur shpërblim a falënderim për karshi kësaj mirësie!

Pra, me dhanë dhe mos me pritë! Me e ushqy armikun me bukë dhe mos me pritë as edhe një falënderim prej tij! Kjo është prej madhështisë së shfaqjes së muslimanit hak!

Dëgjova në një incizim të regjistruar me pamje e zë, deklaratën e Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Antonio Gueterres, ku thotë: "Kur isha në postin e Negociatorit të Lartë për Çështjet e Refugjatëve, pashë bujarinë e shteteve islame, të cilat hapën kufijtë e tyre për

njerëzit e sprovuar, në një botë, ku për fat të keq, shumë kufij janë mbyllur!

Kjo përputhet edhe me atë, që e konsideroj si përshkrimi më i bukur që është thënë në lidhje me mbrojtjen e refugjatëve në historinë e njerëzimit.

Ajo që thuhet në suren "Teube", ajeti 6, në Kur'anin e Shenjtë: "E nëse ndokush prej idhujtarëve të kërkon strehim, ti strehoje në mënyrë që t'i dëgjosh fjalët e All-llahut (Kur'anin), e mandej përcille deri në vendin e tij të sigurt. Këtë, ngase ata janë popull që nuk e di (të vërtetën e fesë islame)"

Ky ajet iu shpall të Dërguarit, paqja qoftë mbi të, para 14 shekujsh, para se të shpallej Konventa për Mbrojtjen e Refugjatëve në vitin 1951!..

A nuk kuptojmë nga ajeti i përmendur në fjalën e z. Gueterres, madhësinë e Islamit në mbrojtjen e tjetrit, edhe mushrik e idhujtar qoftë, që të shohë ndër ne modelin e Islamit në bujarë, mirësi e humanizëm, pastaj ta përcjellim duke u kujdesur për sigurinë dhe mbrojtjen e tij deri në kufijtë e mundësisë?

Pra, ne e presim edhe idhujtarin e të huajin me zemër të hapur e me bukë, duke mos i imponuar fenë! Islami është dritë në zemër, jo shpatë mbi kokë!

Nëse në ajetin e sures El-Insan, mësuam se edhe armikut (të zënëve robër) i japim bukë me zemër, në ajetin e sures Et-Teube, mësojmë se edhe jomuslimanët i presim me bukë e besë, me zemër të pastër e të hapur dhe nuk ia imponojmë fenë askujt!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

(Nga dersi i sabahut, më 14 janar 2020, në xhaminë e Parrucës)

NUK I VJEN E KEQJA AS POPULLIT TONË, AS NJERËZIMIT MBARË, NGA ISLAMI!

Kur flasim për selamin, ne po flasim për një traditë shumë të bukur islame. Dhënia selam ishte veprimi i parë i Hz. Ademit (a.s.) në komunikimin e tij me melekët. Prej këtu kuptojmë edhe vlerën dhe madhësinë e selamit, që është një fjalë e shtrenjtë, të cilën All-llahu i Madhëruar ia mësoi njeriut të parë në xhennet!

Pra, njeriu sot, e deri në ditën e fundit të jetës mbi tokë, kur i jep selam dikujt, çon ndër mend babain e tij të parë teksa i jepte selam melekëve. Me fjalë të tjera, kjo shprehje është e veshur me dritën e Zotit, me mirësi e bekim prej Tij (xh.sh.).

Teksa japim selam, dëshmohe mi se jemi shoqëri e lartë, shoqëri melekësh, shoqëri pastërtie dhe përluleje ndaj Zotit! Si për t'i vërtetuar njëri-tjetrit dhe gjithësisë se, prej nesh nuk vjen e keqja!

E kemi thënë dhe vazhdojmë ta përsërisim se, nuk i vjen e keqja as popullit tonë, as njerëzimit mbarë, nga Islami! Çdo e mirë na ka ardhur nga Islami!

All-llahu i Madhëruar i hapi zemrat e të parëve tanë nërmjet kësaj përshëndetjeje të shtrenjtë! All-llahu i Madhëruar i ndriçoi zemrat e të parëve tanë para shumë shekujsh dhe e përqaftuan me zemër dhe me bindje të plotë, siç e kemi përqaftuar edhe ne, këtë Islam të pastër, me të cilin themi se, All-llahu na nxori nga errësira në dritë!

Çfarë do të ishim, po të mos ishim muslimanë? Çfarë do të ishim po të mos ishim ymeti i selamit? Çfarë do të ishim po të mos i mësonim fëmijëve dhe shoqërisë tonë këtë Islam të pastër, i cili na merr për dore drejt çdo të mire, drejt çdo zhvillimi, drejt dijes, drejt pastërtisë, drejt ruajtjes së vlerave!

Çdo gjë në këtë fé të madhnueshme islame është vlerë! Ne jemi të edukuar me vlera, jetojmë me vlera, përhapim vlera dhe, asgjë të mangët nuk ka në fenë tonë islame! Çdo gjë e kemi në vendin e duhur dhe çdo gjë që buron nga ky Kur'an i madhnueshëm, që vjen nga Zoti i gjithësisë, është i mbushur me bekim dhe urtësi për jetën tonë!

Imam Muhamed B. Sytari

(Nga dersi i sabahut, më 7 janar 2020, në xhaminë e Parrucës)



Idmir Plaku,
Imam - xhamia "Ebu Bekër"

Fëmijëria nuk është periudhë përgjegjësie, por përgatitjeje për të kryer obligimet në moshën e pjekurisë. Rritja e fëmijës me ndjenjën e besimit dhe adhurimit ka një ndikim të madh në formimin e karakterit dhe edukatës së tij. Adhurimi i Allahut (xh.sh), që në moshën e fëmijërisë, krijon një ndjenjë vetëbesimi për të mbajtur përgjegjësi.

Në këtë aspekt, Pejgamberi (a.s) i ka përgëzuar fëmijët që janë rritur dhe formuar në mihabin e adhurimit.

Ebu Umame (r.a) tregon se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Çdo person që rritet me adhurim, derisa t’i vijë vdekja, Allahu i jep shpërblimin e nëntëdhjetë e nëntë personave”.¹ Ndërsa Omer ibn Hatabi (r.a) ka thënë: “Fëmijës i shkruhen veprat e mira dhe jo veprat e këqija”.

Padyshim që xhamia është vendi ku formohen gjenerata, që pasojnë breza besimtarësh. Xhamia ka qenë dhe mbetet burim frymëzimi për besimtarë, që i ka dhënë besën Allahut për të ecur në rrugën e Tij duke ndjekur traditën e Pejgamberit (a.s). Për këtë arsye, sahabët treguan kujdes të veçantë në të bërit të dashur xhaminë për fëmijët, duke i marrë për të falur namazin me Pejgamberin (a.s).

Xhabir ibn Semure (r.a) na tregon për fëmijërinë e tij dhe shoqërimin me Pejgamberin (a.s), duke thënë: “Kam falur me Pejgamberin (a.s) namazin e parë, atë të drekës. Pas mbarimit të namazit, Pejgamberi (a.s) pasi përshëndeti familjen e tij, takoi dy fëmijë, ku çdonjërin e përkëdheli në faqe. Xhabiri (r.a) thotë: “Teksa Pejgamberi (a.s) më përkëdheli në faqe ndjeva në dorën e tij freski dhe aromë, sikur sapo e kishte nxjerrë nga shishja e parfumit”.²

1. Tabarani.
2. Muslimi.

TË AFRUARIT E FËMIJËVE ME XHAMINË

Fëmija në xhami merret atëherë kur ka mundësi të kryejë vetë nevojat personale dhe është i pastër. Fëmija merret në xhami atëherë kur ai ka mësuar edukatën e xhamisë, duke filluar me ruajtjen e qetësisë, vendosjen e këpucëve në rafte, mosvrapsimi në xhami, të mos shqetësojë më të rriturit gjatë faljes së namazit, të dëgjojë me vëmendje ligjëratat që mbahen në xhami, etj. E kundërta e kësaj ndodhë në ditët e sotme, kur shpeshherë shohim prindër që marrin fëmijët e tyre në xhami, të vegjël në moshën e “panelinave”, që shqetësojnë të tjerët gjatë namazit me të qarat, lojërat dhe zërin e tyre të lartë.

Nga ana tjetër vërejmë prindër, që nuk u bëjnë shumë përshtypje situata të tilla anormale shqetësuese për namaz-falësit. Është pyetur Imam Maliku (r.a) për personin që e merr fëmijën e tij në xhami, a është e pëlqyer një gjë e tillë? Ka thënë: *Nëse është i mësuar me edukatën e xhamisë, një veprim i tillë është i pëlqyer, por nëse është i vogël, që luan duke bërë zhurmë, nuk e pëlqej një gjë të tillë.*³ Në kontekst të përgjigjes së Imam Malikut (r.a) duhet të kuptojmë hadithin e Pejgamberit (a.s) që thotë: “Mbani larg xhamisë fëmijët tuaj të vegjël, të sëmurët mendorë, shitblerjen, armiqësitë, të bërtiturat, dhënien e ndëshkimeve, mbajeni pastër dhe parfumeseni”.⁴

Sahabët kanë qenë të kujdesshëm për t’i afruar fëmijët e tyre me xhaminë, ta ndjenin si një obligim. Për ata, xhamia ishte vatër dijeje, ilmi-hali i kohës së tyre. Në xhami shkonin për të mësuar dhe kryer obligimet dhe jo për të kaluar kohën, shqetësuar të tjerët gjatë faljes. Pejgamberi (a.s) e ka vlerësuar sakrificën e fëmijëve, prezencën e tyre në namaz dhe ka tërhequr vëmendjen e imamëve duke thënë: “Secili nga ju që falet imam, le ta shkurtojë namazin, meqë pas jush ka të moshuar, fëmijë dhe nevojtarë”.⁵

Marrja e fëmijëve në xhami nga prindërit për të falur namazin, ka ndikim në formimin e tyre me ndjenjën e besimit, dashurinë për xhaminë dhe kënaqësinë për të marrë pjesë në tubime e ligjëratat që mbahen në mënyrë periodike.

Duke e marrë fëmijën në xhami, ai rritet me frymën e saj. Ditët e

3. Et-Terbijetu fil- slam, Dr. Ahmed Ehvani, f. 282.
4. Ibn Maxheh, Tabariu nga Ebu Derda dhe Ebu Umame (r.a).
5. Muttefekun alejhi, transmetuar nga Ukbe ibn Amër (r.a).

frekuentimit të xhamisë në moshën e fëmijërisë mbeten gjatë në kujtesë, sepse ato janë ditët më të bukura. Brezat e parë të besimtarëve marrjen e fëmijëve në xhami e kanë vlerësuar si një parapërgatitje për dhënie stafetës së besimit brezit të ri.

Pejgamberi (a.s) e ka përgëzuar dhe e ka inkurajuar të afruarit e fëmijëve me xhaminë. Ebu Hurejra (r.a) thotë: “E kam dëgjuar Pejgamberin (a.s) duke thënë: “Shtatë lloje njerëzish Allahu (xh.sh) do t’i vendosë nën hijen e Tij, kur hije tjetër nuk do të ketë: Sundimtarin e drejtë, njeriun që është rritur i nënshtruar ndaj Allahut, njeriun zemra e të cilit është e lidhur me xhaminë...”⁶

Adhurimi i Allahut (xh.sh) ka një ndikim të madh tek sjellja e fëmijës, e disiplinon, e ndërgjegjëson, i shton vullnetin për të mbajtur përgjegjësi, etj.

Në ditët e sotme është e rëndësishme të kuptojmë se xhamitë, nga të cilat u formuan dhe u përgatitën fëmijët e sahabëve, brezave të parë të besimtarëve, janë në gjendje dhe të afta të përgatisin burra, besimtarë të ngjashëm me ta, nëse prindërit fëmijët e tyre i afrojnë me xhaminë duke i inkurajuar dhe jo larguar, duke iu bërë të dashur dhe jo urreyer, duke i simpatizuar dhe jo përbuzur.

Po kështu, edhe më të rriturit duhet të kuptojnë edhe më shumë natyrën e fëmijës e aq më tepër në ditët e sotme.

Për fëmijët, dera e xhamisë mbetet përherë e hapur, duke ruajtur edukatën brenda saj. Duke i mësuar me edukatën e xhamisë, fëmijëve ua bëjmë atë vend të dashur dhe jo të mërzitshëm, vend qetësie dhe jo zhurme, vend pastërtie dhe jo ndryshe! Duke i mësuar fëmijët me edukatën e xhamisë ua kemi bërë të dashur Islamin në zemrat e tyre.

Këshilla ime për prindërit, nëna e baballarë është ajo e sahbiut Abdullah ibn Mes’ud (r.a), që ka thënë: “Këshilloni fëmijët tuaj për namazin, mësojini mirësinë sepse u bëhet traditë”.⁷

Së fundmi, i lutemi Allahut (xh.sh): “Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me punën e grave tona dhe pasardhësve tanë e neve na bëj shembull për të devotshmit”.⁸

6. Muttefekun alejhi.
7. Bejhakiu.
8. Kur’ani, El Furkan: 74.



Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Transmetohet nga Ebu Berzete El-Eslemij (Allahu qoftë i kënaqur me të) se Pejgamberi (a.s) ka thënë: Nuk do të lëvizin, këmbët e njeriut në ditën e Gjykimit derisa të pyetet për katër gjëra:

1. Për jetën e tij; Si e ka kaluar? Allahu (xh.sh) thotë: “Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zburim, si dhe mburrje e garë ndërmjet jush për më shumë pasuri dhe fëmijë!”¹ Duam apo nuk duam, kjo jetë i ngjan një ëndrrë dhe ëndrra kuptohet se ka qenë ëndërr, vetëm pasi zgjohemi. Kështu edhe ne do ta kuptojmë se kemi qenë në ëndërr, vetëm pasi të vdesim. “O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që ju bëni!”²

2. Për diturinë e tij; Çfarë ka vepruar? Pejgamberi (a.s) tregon se në Ditën e Gjykimit dikush do të dënohet në zjarrin e xhehenemit me një dënim të tmerrshëm. Banorët e xhehenemit do të mbliidhen rreth tij dhe do ta pyesin: “O filan, ç’është me ty, pse po dënohesh?”

1. Kur’ani, El-Hadid, 20.
2. Kur’ani, El-Hashr, 18.

KATËR GJËRA PËR TË CILAT DO TË PYETEMI

A nuk na ke urdhëruar për të mira dhe na ke ndaluar nga e keqja në dynja?” Do të përgjigjet: “Po, ju kam urdhëruar për të mirë, por nuk e kam zbatuar për vete. Ju kam ndaluar nga e keqja, por e kam vepruar të keqen për vete.”³ Dijetarët tanë e kanë krahasuar “diturinë me pemën, ndërsa veprimin me frytin. Pra, dituria pa veprim është si pemë pa kokra...dituria është shërbetor i veprimit dhe veprimi është synim i diturisë...sa i vlen të verbërit drita e diellit, aq i vlen edhe të diturit dituria me të cilën nuk vepron”.

3. Për pasurinë e tij; Ku e ka fituar dhe ku e ka shpenzuar? Njerëzit në raport me pasurinë ndahen në disa grupe:

a. Janë ata që e fitojnë pasurinë në formë të lejuar dhe e shpenzojnë në gjëra të lejuar. Këta janë të shpëtuarit nga dënimi i Allahut Ditën e Kiametit.

b. Janë ata që e fitojnë pasurinë nga gjërat e ndaluara dhe e shpenzojnë në hareme.

c. Janë ata që e fitojnë pasurinë në formë të lejuar dhe e shpenzojnë në gjëra të ndaluara.

d. Janë ata që e fitojnë pasurinë në formë të ndaluar dhe e shpenzojnë në gjëra të lejuara. Allahu nuk e pranon prej tyre këtë shpenzim, sepse Allahu i Madhëruar është i mirë dhe nuk pranon vetëm se të mirën.

I Dërguari i Allahut (a.s) i ka thënë Ebu Dherrit (r.a): “O Ebu Dher! A mendon se nëse posedon shumë pasuri atëherë do të jesh i pasur? Me të vërtetë pasuria e vërtetë është pasuria e zemrës dhe varfëria e vërtetë është varfëria e

zemrës.”

Ai që në zemer është i pasur, nuk e dëmton ajo që i ndodhë në dunja. Ndërsa ai që në zemër është i varfër nuk pasurohet edhe nëse e posedon gjithë pasurinë e kësaj bote.⁴

4. Për trupin e tij; Se si e ka shfrytëzuar.⁵ Edhe gjymtyrët e trupit, si: duart, këmbët, gjuha, sytë, veshët etj. Të gjitha këto do të dëshmojnë pro ose kundër nesh në Ditën e Gjykimit. Allahu (xh.sh) thotë: “Sot Ne do t’ua vulosim atyre gojë e do të na flasim duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre për atë që kanë bërë”.⁶

Enesi (r.a) transmeton e thotë: Një herë ishim tek i Dërguari i Allahut e ai qeshi dhe tha: A e dini përse po qesh? – thotë: I thamë: Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë. – Tha: Prej dialogut të robit me Zotin e tij. Ai (robi) do të thotë: O Zot! A nuk më ke dhënë siguri se nuk ka padrejtësi?! – tha – Thotë (Allahu): Posi jo. – Thotë (robi): Atëherë unë nuk lejoj askënd të dëshmojë për mua veç vetes sime! – tha – I thotë (Allahu): Mjafton ti si dëshmitar ndaj vetes tënde dhe “shkruesit e ndershëm” (melekët Kiramen Katibin). (Rregjistruesit besnikë, më të saktë se çdo aparat inçizues). Thotë (Profeti): Atëherë i mbyllet goja dhe u thuhet gjymtyrëve të tij: Flisni! – Dhe ato tregojnë punët e tij! Pastaj i jepet leje përsëri gojës së tij dhe ai thotë: Mallkuar qofshi! Unë për ju po luftoja!”⁷

4. Nesaïu.
5. Tirmidhiu, 4/612.
6. Kur’ani, Jasin, 65.
7. Muslimi, 2969.

“TA DINI, SE JETA NË KËTË BOTË,
NUK ËSHTË TJETËR VEÇSE LOJË,
DËFRIM E ZBUKURIM, SI DHE MBURRJE
E GARË NDËRMJET JUSH PËR MË SHUMË
PASURI DHE FËMIJË!” - (KUR’ANI, EL-HADID: 20)



Dr. Mustafa Mahmud

Miku im, doktor thotë: A, nuk je dakord me mua, se Islami ka një qëndrim prapambetës ndaj gruas?

Dhe, filloi t'i numërojë me gishtërinjtë e tij: Çështja e poligamisë dhe qëndrimit të gruas në shtëpi; hixhabi dhe divorci në dorën e burrit; goditja e saj dhe largimi nga shtrati i martesës; çështja dhe “çfarë posedojnë të djathtat (duart) tuaja” (robërshat e luftës); çështja “burrat janë superior ndaj grave” dhe dyfishi i trashëgimisë që merr mashkulli në trashëgimi.

Fillova t'i them, ndërkohë që unë mbloodha veten: Këtë herë akuzat janë të shumta dhe biseda për to është e gjatë, le të fillojmë nga fillimi.

Përpara Islamit dhe, ti e di absolutisht mirë, se Islami ka ardhur në kohën e injorancës (xahilijetit), e vajza që lindte, fati i saj ishte varrosja për së gjalli në rrërë. Burri martohej me dhjetë dhe njëzet gra, e i detyronte robërshat e tij të bënin imoralitet kundrejt pagesës. Kështu që, lejimi i Islamit martesën me katër gra e solli kufizim dhe poligami, dhe e shpëtoi femrën prej turpit, vdekjes, robërisë dhe poshtërsisë.

A, është gruaja sot në Evropë në gjendje më të lumtur, në degjenerimin e përhapur atje dhe numrin e shumtë të të dashurave, gjë e cila tashmë është bërë realitet në pjesën më të madhe të martesave? A, nuk është më fisnike për gruan të jetë grua e dytë për atë që e dashuron, me të drejtat e bashkëshortes dhe respektimin e saj, se sa të jetë e dashur e fshehtë, duke vjedh kënaqësinë pas mureve?

E, megjithatë, Islami e ka bërë lejimin e poligamisë gati të pamundur, sepse ka kushtëzuar kushte, që vështirë të realizohen, e ato janë drejtësia mes grave.

“E, nëse keni frikë se nuk do të bëni drejtësi, atëherë (martohuni vetëm) me një” – (Kur’ani, En-Nisa: 3), “Kurrë nuk do të mundeni të bëni drejtësi mes grave

PO TRAJTIMI QË ISLAMI I BËN GRUAS?

edhe nëse kujdeseni (të jeni të tillë)”. – (Kur’ani, En-Nisa: 129)

Kështu që, ka mohuar aftësinë e të bërit drejtësi, madje edhe nga i kujdesshmi, e nuk ka mbetur, vetëm se për ata, që janë më shumë se sa të kujdesshëm, profetët dhe evliatë dhe të tjerët që janë në gradën e tyre.

Ndërsa, për sa i përket qëndrimit në shtëpi, ky është një urdhër për gratë e Profetit, duke i konsideruar ato shembull i lartë.

“Dhe, qëndroni në shtëpitë tuaja”. – (Kur’ani, El-Ahzab: 33)

Kjo është një shenjë, se situata më shembullore për një grua është, që ajo të jetë nënë dhe edukatore e shtëpisë, duke iu përkushtuar shtëpisë dhe fëmijëve të saj.

Mund ta imagjinojmë gjendjen e një populli ku gratë janë në rrugë dhe në zyra, e fëmijët e tyre janë në kopshte dhe çerdhe, a është gjendja më e mirë e tyre apo e një populli tjetër ku gratë i kanë nëna, zonja shtëpie dhe edukatore të fëmijëve, duke u rritur në prehrin e nënave të tyre dhe familja i ka të plotësuarat të gjitha shërbimet?

Përgjigjja është e qartë.

E, megjithatë, Islami nuk i ka ndaluar gjërat e domosdoshme, të cilat thërrasin për daljen nga shtëpia të gruas dhe punën e saj. Në Islam ka pasur dijetare dhe poete dhe gratë dilyn në luftëra dhe dilyn për të kërkuar dituri.

Udhëzimet e ajetit janë për gratë e Profetit, si shembulli më i lartë dhe, mes shembullit të lartë, të mundurës dhe realitetit ka shumë dallime.

Gratë e Profetit kanë dalë së bashku me Profetin në betejat e tij. Kjo gjë sjell se dalja është për të ndihmuar bashkëshortin në përpjekjen e tij fisnike dhe kjo është një gjë, që nuk ka dyshim në të.

Ndërsa, hixhabi, ai është në dobi të gruas.

Islami e ka lejuar zbulimin e fytyrës dhe të duarve, dhe ka urdhëruar të mbulohet gjithçka tjetër, përveç kësaj. Është e ditur, se ajo që është e ndaluar është e dëshiruar dhe se mbulimi i vendeve joshëse i shton asaj forcën tërheqëse.

Në mesin e fiseve primitive dhe për shkak të lakuriqësisë së plotë, tek ata mbaron plotësisht dëshira intime dhe joshja. Shohim, se burri nuk rri me gruan e tij, vetëm se një herë në muaj dhe nëse ngelet shtatzënë, ai largohet dy vite prej saj.

Bregdeteve në verë, kur shtohet mishi (trupit) i zhveshur lakuriq dhe i lejuar

për syrin, trupi i zhveshur e humb forcën tërheqëse, butësinë dhe joshjen e tij, duke u bërë një gjë e zakonshme, që nuk nxit për më tepër.

Nuk ka dyshim, se është në dobi të femrës, që ajo të jetë më shumë tërheqëse dhe të mos shndërrohet në një gjë të zakonshme që nuk joshë.

Për sa i përket, të drejtës së burrit për të divorcuar, kjo përballet gjithashtu me të drejtën e gruas në anën tjetër dhe ajo mund të kërkojë divorcin në gjykatë dhe ta fitojë atë, nëse paraqet justifikimet e mjaftueshme.

Gruaja mundet të kushtëzojë në aktin e martesës, se ajo gëzon të drejtën e saj dhe me këtë gjë ajo ka të drejtën e divorcit ndaj burrit.

Islami i jep gruas të drejta, ku gruaja nuk mundet t'i fitojë në Evropë. Gruaja tek ne merr mehrin (prikën), ndërsa tek ata, gruaja paguan për martesën. Tek ne, gruaja ka të drejtë të veprojë si të dojë me pasurinë e saj, ndërsa tek ata, ajo e humb këtë drejtë thjeshtë vetëm duke u martuar dhe burri bëhet përgjegjës për këtë pasuri të saj.

Ndërsa, të qëlluarit dhe largimi prej shtratit të martesës, kjo sjellje është vetëm për gruan e pabindur (me sjellje të keqe), ndërkohë gruaja normale, ajo tek burri ka të drejtën e dashurisë dhe të mëshirës.

Të qëlluarit dhe largimi nga shtrati i martesës është prej mrekullive të Kur’anit në të kuptuarit e mosbindjes (sjelljes së keqe). Kjo gjë përputhet me arritjet më të reja të fushës së psikologjisë bashkëkohore në të kuptuarit e sjelljes së sëmurë të gruas.

Siç e di, shkenca e psikologjisë e ndan në dy pjesë këtë sjellje të sëmurë: Metoda e nënshtrimit, e cila në gjuhën terminologjike shkencore quhet “masoshizëm” dhe që është gjendje e sëmurë, në të cilën femra kënaqet dhe ajo pranon të qëllohet dhe të ndëshkohet, e të jetë pala e nënshtruar.

Pjesa e dytë: Metoda sunduese, e cila në gjuhën terminologjike shkencore quhet “sadzizëm” dhe që është gjendje e sëmurë, në të cilën femra kënaqet duke sunduar, duke mbizotëruar, duke u treguar superiore dhe duke ndëshkuar palën tjetër.

Shembulli i kësaj gruaje nuk ka zgjidhje tjetër, vetëm se t'i hiqet dëshira e saj dhe t'i merret “arma” e saj me të cilën sundon dhe, arma e gruas është feminizmi, e kjo duke u larguar prej saj nga shtrati i

martesës, e kështu nuk i mbetet armë, me të cilën sundon.

Ndërsa, gruaja e cila nuk e gjen kënaqësinë e saj, vetëm se në nënshtrim dhe në të qëlluar, atëherë të qëlluarit është mjekimi i saj. Prej këtu shohim se fjalët e Kur’anit: “Largoni ato nga shtrati i martesës dhe qëllojini”, janë mrekulli shkencore dhe përmbledhje me dy fjalë e gjithë asaj që ka arritur shkenca e psikologjisë në vëllime të tëra për femrën e pabindur (me sjellje jo të mirë) dhe mjekimin e saj.

Për sa i përket, çështjes “çfarë posedojnë të djathtat (duart) tuaja” (robërshat), të cilën na e bëri me shenjë pyetësi, kjo gjë na merr për dore drejt temës së skllavërisë në Islam dhe akuzave të orientalistëve ndaj Islamit, se ai ka bërë thirrje për skllavëri. E vërteta është, se Islami nuk ka thirrur për skllavëri, madje është feja e vetme, e cila ka bërë thirrje për zhdukjen e skllavërisë.

Sikur të lexojmë Inxhilin dhe çfarë thotë Pali i dërguari në letrat e tij për banorët e Efesit dhe me çfarë i porositi skllëverit, do të gjejmë, se ai i thërret krejt qartë skllëverit të jenë të bindur ndaj zotërinjve të tyre, sikur ndaj Zotit.

“O ju skllëvër, binduni zotërinjve tuaj me frikë dhe rrëqethje me thjeshtësinë e zemrave tuaja, sikur ndaj Zotit”.

Inxhili nuk ka urdhëruar për zhdukjen e skllavërisë si sistem, por maksimalja që ka kërkuar, ka qenë dashuria dhe sjellja e mira mes skllëvërve dhe zotërinjve të tyre.

Në Teuratin që është në përdorim, fati i të lirëve ka qenë më i keq se fati i skllëvërve. Prej porosive të Teuratis është, se kur një vend dorëzohet pa luftë, fati i banorëve të tij është të bëhen robër dhe skllëvër të gjithë. Ndërsa, ai vend që mbron veten e tij me luftë, pastaj dorëzohet, banorët e tij u drejtohen shpatave, ku pleqtë, të rinjtë, gratë dhe fëmijët priten të tërë në qafë.

Kështu që, skllavëria ka qenë një e vërtetë e padiskutueshme përpara se të vinte Islami dhe fetë e tjera të mëparshme porosisnin për bindje të skllëvërve ndaj zotërinjve të tyre.

Zbriti Kur’ani për të qenë Libri i parë qiellor, që flet për lirinë e skllëvërve dhe faljen e lirisë.

Kur’ani nuk e ka ndaluar skllavërinë me tekst të qartë dhe nuk ka urdhëruar për lirinë e tyre, sepse lirim papritur i tyre dhe me urdhër kur’anor në atë kohë, ndërkohë që ata ishin me mijëra, pa asnjë zanat, pa asnjë punë shoqërore, pa asnjë punësim që mund t'i përfshinte, i gjithë kuptimi i kësaj do të ishte një katastrofë shoqërore; kuptimi i kësaj do të thoshte

dalje në rrugë e mijëra të pastrehëve, duke kërkuar ndihmë prej njerëzve, e do të vidhnin dhe do të bënin edhe punë imorale për të siguruar kafshatën e gojës. Dhe, kjo gjë është më e keqe se skllavëria, prandaj zgjidhja kur’anore ishte të mbyllje derën e skllavërisë, pastaj eliminimi i asaj që ekzistonte. Burimi i skllavërisë në atë kohë ishte skllavërimi i robërve të luftës dhe Kur’ani urdhëroi, që robërit të lihen të lirë dhe të merret prej tyre shpagim, në mënyrë që robërit të mos skllavëroheshin.

“Ose dhurim më pastaj, ose shpagim”. – (Kur’ani, Muhammed: 4)

Ose t'i lësh të lirë robërit për hir të Allahut, ose të marrë shpagim prej tyre.

Ndërsa, skllëverit që ekzistonin në realitet, atëherë lirim i tyre do të bëhej shkallë-shkallë dhe kjo duke e bërë faljen e lirisë skllavit dhe lirimin e robit të luftës si pastrim të mëkateve, të vogla dhe të madha, e me këtë mënyrë do të përfundonte skllavëria gradualisht.

Derisa të vinte ky përfundim, si do të ishte marrëdhënia e zotërisë ndaj asaj që posedonte? Islami e kishe lejuar ta trajtonte atë si grua. Dhe, kjo është çështja “çfarë posedojnë të djathtat (duart) tuaja” (robërshat), të cilën e bëri me shenjë pyetësi dhe nuk ka aspak dyshim, se marrëdhënia e femrës robërshë si bashkëshorte, në atë kohë ishte nderim dhe jo përcmim.

Duhet të mos harrojmë qëndrimin e Islamit ndaj robërve skllëvër dhe si ai bëri ata vëllezër, pasi që ishin skllëvër që shtypeshin me këmbë.

“Me të vërtetë, besimtarët janë vëllezër”. – (Kur’ani, El-Huxhurat: 10)

“Ai, është i Cili ju krijoi prej një qenieje të vetme”. – (Kur’ani, El-Araf: 189)

“Mos e merrni njëri-tjetrin si zot, përveç Allahut”. – (Kur’ani, Ali Imran: 64)

Muhammedi (a.s) ka dhënë shembullin më të lartë, ndërkohë që adoptoi si fëmijë të tij një skllav, e ai ishte Zejd ibn Harithe, e liroi nga skllavëria dhe e bëri si djalin e tij. Pastaj, e martoi me një grua të lirë, që rridhte nga një familje fisnike, Zejneb bint Xhahësh.

E gjitha kjo, për të thyer këtë racizëm dhe mburrje (mendjemadhësi), e për të bërë lirinë e skllëvërve qëndrim, që duhet pasuar dhe për të thënë me vepër dhe me shembull, se Mesazhi i tij është lirim nga skllavëria.

Sa i përket çështjes: “burrat janë superiorë ndaj grave”, kjo është një realitet në çdo vend islam dhe në vendet e krishtera, edhe në vendet që nuk njohin zot as fe.

Në Moskën ateiste, udhëheqësit janë

burra nga koha e Leninit dhe Stalinit, Hrushovit dhe Bulganinit e deri më sot; në Francë, udhëheqësit janë burra; në Londër, udhëheqësit janë burra; dhe në çdo vend të botës burrat janë ata, të cilët sundojnë, nxjerrin ligje, shpikin, e të gjithë Profetët kanë qenë burra; të gjithë filozofët kanë qenë burra, madje edhe kompozitorët, megjithëse kompozimi është prodhim i imagjinatës dhe nuk ka nevojë për burra, ashtu siç thotë edhe Akadi duke ironizuar: Madje edhe gatimi, trikotomi dhe moda, që janë specialitete femrash, burrat ua kanë kaluar dhe pastaj janë veçuar në to.

Këto janë dukuri, ku sheriatu islam nuk ka lidhje. Këto janë dukuri të përgjithshme në çdo vend të botës, aty ku nuk sundon sheriatu islam dhe nuk sundon Kur’ani.

Kjo është realitet, se burri është superior ndaj gruas me ligj të natyrës, përshtatshmëri dhe legjitimitet, me të cilin e ka veçuar Krijuesi.

E, nëse shfaqet ndonjë ministre, kryetare, apo udhëheqëse, atëherë ajo është origjinalja, e cila jep lajmet e saj dhe përjashtimi i cili vërteton rregullin bazë.

Islami nuk ka bërë më shumë, se sa të regjistrojë këtë rregull bazë, e ky është shpjegimi jonë pas gjithë kësaj, përse Kur’ani i ka dhënë burrit dyfishin e pjesës së trashëgimisë.

Sepse, ai është i cili shpenzon dhe sepse ai është ai cili mban familjen. Dhe, sepse, ai është i cili punon.

Qëndrim i Islami ndaj gruas është drejtësi.

Jeta e Profetit me bashkëshortet e tij ka qenë dashuri, ngrohtësi dhe butësi, nga i cili na është transmetuar: “Prej dynjasë tuaj më janë bërë të dashura gratë, aroma e mirë dhe më është bërë kënaqësia e syrit në namaz”.

I ka përmendur gratë me aromën e mirë dhe me namazin, e kjo është kulmi i nderimit. Fjala e fundit, që e ka thënë, në hytben e tij, përpara se të ndërroi jetë, ka qenë porosia për sjellje të mirë ndaj grave.

Nëse Allahu ka zgjedhur gruan për shtëpi dhe burrin për jashtë, kjo sepse burrit i ka ngarkuar amanetin e prodhimit, ndërtimit dhe zhvillimit, ndërkohë që gruas i ka ngarkuar një amanet më fisnik dhe më të madh, e ai është ndërtimi i vetë njeriut.

Me të vërtetë ai është më i madhi për çështjen e gruas, t’ia besosh këtë amanet.

Prandaj, a i ka bërë zullum Islami grave?!

(Marrë nga libri: DIALOG ME MIKUN TIM ATEIST)

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

HISTORIA E SHPËTIMIT TË HEBRENJVE NË SHQIPËRI NUK FILLON NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE, POR DATON QË PARA 5 SHEKUJSH

Një aspekt interesant i pranisë së Spanjës në Shqipëri në shek. XVI ishin edhe nënshetësit spanjollë të fesë hebraike që ishin dëbuar nga atdheu i tyre iberik. Ky dëbim nga Gadishulli Iberik fillon nga fundi i shek. XV dhe përbën një kapitull tragjik të historisë mijërvjeçare të hebrejve.

Ashpërsimi i lëvizjes antisemite dhe antimyslimane arriti kulmin me shpalljen e dekretëve mbretërorë të posaçme të çiftit mbretëror spanjoll Ferdinandi dhe Isabela, më 31 mars të vitit 1492 për dëbimin dhe konvertimin zyrtar të hebrejve dhe myslimanëve nga Spanja dhe Sicilia. Shembullin e tyre u detyrua ta ndjekë edhe sovranin i Portugalisë, Manueli I, i cili më 5 dhjetor të vitit 1496 shpalli gjithashtu dëbimin dhe konvertimin e hebrejve dhe myslimanëve portugezë.

Në kontrast me këtë politikë ekstremiste zyrtare, sulltani osman Bajaziti II, duke u mbështetur në frymën e sheriatit, shpalli në vitin 1492 një dekret për pranimin në tokat e Perandorisë Osmane të të gjithë refugjatëve hebrej të dëbuar nga Spanja, Portugalia dhe vendet e tjera të krishtera. Trojet shqiptare u bënë një nga korridoret kryesore të eksodit të hebrejve drejt shtetit osman që i mikpriti pa mëdyshje. Atyre u garantohej liria e vendosjes në territorin osman dhe në të njëjtën kohë urdhëroheshin autoritetet osmane të merrnin të gjitha masat për të lehtësuar hyrjen dhe ngulimin e hebrejve iberikë

në territoret e qeverisura prej tyre.

Kronisti hebre i shek. XVI Rabini Eliyahu Capsali shkon deri aty sa thotë se Sulltan Bajaziti II dërgoi emisarë tek hebrejtë spanjollë për t'i mikpritur kur mori vesh për masat e ndërmarrja nga shtetet iberike për dëbimin e tyre. (R. Eliyahu Capsali, Seder Eliyahu Zutta, vëll. I, Jeruzalem, 1976, f. 218-219). Kështu dëshmime sporadike të pranisë së tyre në Shqipëri gjatë mesjetës u shtohen edhe dokumentet që tregojnë për kthimin e porteve shqiptare në një derë mikpritjeje ndaj tyre në periudhën e persekutimit dhe dëbimit nga Spanja dhe Portugalia, por edhe nga shtete të tjera të Europës.

Duke qenë porti shqiptar më i rëndësishëm nën sundimin osman, Vlora u bë menjëherë një nga dyert e shpëtimit për këta hebrej. Edhe pse një pjesë e madhe e atyre që mbërrinin në Vlorë, vazhdonin rrugën drejt qyteteve të tjera të shtetit osman si Stambolli, Selaniku apo Izmiri, numri i atyre që zgjidhnin të qëndronin në qytet ishte aq i madh, sa që praktikisht në shek. XVI Vlora u shndërrua në një qytet shqiptaro-hebre. Deri në këtë kohë ka shumë pak të dhëna për praninë e tyre në Vlorë, por në shek. XVI numri i bashkësisë hebreje të Vlorës u shumëfishua.

Kryeqendra e perandorisë, Stambolli dhe disa qendra të tjera të rëndësishme urbane si Selaniku, Sarajeva, Shkupi etj., u mbushën me ardhës të rinj hebrej nga vende të ndryshme të Perëndimit.

Një peshë të konsiderueshme në mërgatën hebraike të kësaj kohe kishin edhe hebrejtë italikë, të cilët u shpërngulën nga rajone të ndryshme të Italisë (Pulia, Ankona, Venecia, Napoli etj.). Nganjëherë kjo përndjekje e hebrejve i tejkalonte kufijtë formalë politikë. Në prill të vitit 1502, një anije që ishte nisur nga Pulja në drejtim të Vlorës, u sulmua nga spanjollët, të cilët sipas një rrëfimi mbytën 20 pasagjerë hebrej që synonin të mbërrinin në tokën shqiptare. Pasuria e viktimave u shit në Raguzë, kurse sulmuesit nuk patën asnjë qortim nga askush. Edhe në Raguzë dokumentohet transportimi i tyre drejt Selanikut e Stambollit që në vitet 1501-1502 dhe njëkohësisht edhe përshkrime të sulmeve të shtuara ndaj anijeve që transportonin hebrej.

Hebrejtë sefarditë që u vendosën në Vlorë shumë shpejt filluan ta përdorin pozitën e këtij porti për të zhvilluar tregtinë me bregun perëndimor të Adriatikut. shumë shpejt këta hebrej u integruan në jetën e vendit mikpritës sa që në verë të vitit 1534, Venediku ankohej tek sulltan Sulejmani I se një levend i quajtur Sinan hebreu kishte kryer inkursione në Korfuz dhe kishte dëmtuar anije të ngarkuara me drithë. Madje jo vetëm që ishin tregtarë, por edhe kishin anijet e tyre me të cilat bënë tregti.

Të sigurt nga përkrahja dhe të drejtat që gëzonin në Shqipërinë osmane, hebrejtë e Vlorës kishin edhe statusin e rezidentit në Venecia dhe në qytetet italiane të bregut adriatik Këtë

NË KONTRAST ME KËTË POLITIKË EKSTREMISTE ZYRTARE, SULLTANI OSMAN BAJAZITI II, DUKE U MBËSHTETUR NË FRYMËN E SHERIATIT, SHPALLI NË VITIN 1492 NJË DEKRET PËR PRANIMIN NË TOKAT E PERANDORISË OSMANE TË TË GJITHË REFUGJATËVE HEBRENJ TË DËBUAR NGA SPANJA, PORTUGALIA DHE VENDET E TJERA TË KRISHTERA. TROJET SHQIPTARE U BËNË NJË NGA KORRIDORET KRYESORE TË EKSODIT TË HEBRENJVE DREJT SHTETIT OSMAN QË I MIKPRITI PA MËDYSHJE.

e dëshmojnë regjistrat e siguracionit të anijeve për vitet 1592-1609. Bashkësia hebraike e Vlorës në shek. XVI përbënte bashkësinë më të madhe hebraike në Rumeli pas asaj të Selanikut. Regjistrimi osman i vitit 1519-1520 e pasqyron realitetin e ri hebraik të Vlorës, pasi përkrah 945 familjeve të krishtera dhe 85 myslimane, dalin edhe 528 familje hebreje. (Ferit Duka, "Deferi osman i regjistrimit të pronave dhe të popullsisë të sanxhakut të Vlorës i vitit 1520", Studime Historike, 3-4 (Tiranë, 1991), f. 167-199.) Edhe pesha e kësaj bashkësie në ekonominë e qytetit ishte po aq e rëndësishme, veçanërisht në fushën e kreditimit financiar dhe të tregtisë.

G. Veinstein ka analizuar peshën e tyre në jetën e qytetit të Vlorës në bazë të të dhënave të Regjistrat (Sixhilit) të Kadiut të Vlorës të viteve 1567-1568. Edhe pse porti i Vlorës më së pari shërbente si pikëmbërritje e hebrejve iberikë që më pas vazhdonin drejt qyteteve të tjera të shtetit osman, edhe ajo pjesë që vendosi të qëndrojnë në Vlorë ishte e mjaftueshme për ta shtuar bashkësinë hebraike në qytet deri në rreth 40% të popullsisë totale. Edhe kur Pouqueville e vizitoi Vlorën

që në atë kohë të fillimshekullit XIX kishte rreth 6 mijë banorë, në mesin e tyre jetonin edhe një numër jo i madh hebrejsh të deportuar nga Ankona prej Papës Pali IV.

Përveç tregtisë dhe financës, një nga rolet më të rëndësishme që hebrejtë kryenin ishte ai i ndërmjetësimit të lirim të robërve. Më 18 qershor 1539, Franjo Sarmiento, qeveritari spanjoll i Hercegnovit i shkruante një fisniku raguzas, se një dinjitar i lartë spanjoll ishte zënë rob kur po udhëtonte nga Hercegnovi për në Pulia. Ky spanjoll i kishte kërkuar që ti dërgonte 60 dukate ari, tek rabini i Vlorës Angjelo Aniel për ta liruar nga robërimi. Po ashtu në 1541 konsulli raguzan në Vlorë, hebreu Samuel Angjelo, lroi një numër robërish raguzanë të rrëmbyer së bashku me anijen e tyre nga korsarë algerianë.

Në periudhën e betejës së Lepantit, më 1571, pesë banorë të ishullit të Lastovos që i përkiste Raguzës kishin rënë rob, duke përfunduar në Vlorë. Konsulli raguzas, hebreu Jakov Koduto dhe i vëllai, Abrahami u përfshinë në traktativat e lirim. Caktimi i konsujve me origjinë hebreje si përfaqësues të Raguzës në Vlorë duket se pasqyronte këtë rëndësi që elementi hebre kishte në Vlorë. Familja hebreje Coduto mund të konsiderohet si një dinasti konsujsh raguzanë në Vlorë, pasi edhe në vitet 1610-1620 konsull i Raguzës në Vlorë ishte një nga kjo familje, Daniel Coduto. Një nga detyrat më të rëndësishme të tij ishte siguri i sasive të nevojshme të drithit në Vlorë për furnizimin e Raguzës.

Sipas I. Burdelez, ("Jewish Consuls", f. 340), caktimi i një hebreu si konsull i Raguzës në Vlorë arsyetohej me faktin që Vlora "had always been the centre of a strong Jewish community which had considerable influence on local authorities and on development of trade not only in Albania but also throughout the Balkans". Bashkësitë hebraike të Vlorës ashtu si edhe bashkësitë e tjera në Perandorinë Osmane u përfshinë në procesin e islamizimit. Në vitin 1647 përmendet si myteselim i Sanxhakut të Vlorës një Hysen Davidliu, që për nga emri duket qartë se ishte nga ndonjë familje hebreje e islamizuar.

(Marrë me shkurtime nga libri i Ardian MUHAJ, Nga Ballkani në Mesdhe. Shqiptarët prej Mesjetës në agimin e Kohës së Re, Tiranë, 2019, f. 107-113)



ANTONIO GUTERRES

(Sekretar i Përgjithshëm i OKB-së)

"Kur isha në postin e Negociatorit të Lartë për Çështjet e Refugjatëve, pashe bujarinë e shteteve islame, të cilat hapën kufijtë e tyre për njerëzit e sprovuar, në një botë, ku për fat të keq, shumë kufij janë mbyllur!

Kjo përputhet edhe me atë, që e konsideroj si përshkrimi më i bukur që është thënë në lidhje me mbrojtjen e refugjatëve në historinë e njerëzimit.

Ajo që thuhet në suren "Teube", ajeti 6, në Kur'anin e Shenjtë: "E nëse ndokush prej idhujtarëve të kërkon strehim, ti strehoje në mënyrë që t'i dëgjosh fjalët e All-llahut (Kur'anin), e mandej përcille deri në vendin e tij të sigurt. Këtë, ngase ata janë popull që nuk e di (të vërtetën e fesë islame)".

Ky ajet iu shpall të Dërguarit, paqja qoftë mbi të, para 14 shekujsh, para se të shpallej Konventa për Mbrojtjen e Refugjatëve në vitin 1951!.."

KUVAJTI, OSE SHTETI I KUVAJTIT

KUVAJTI

Kuvajti, ose Shteti i Kuvajtit, është një vend i vogël që gjendet në Lindjen e Mesme, në perëndim të kontinentit të Azisë, më saktësisht, në veri-perëndim të Gjirit Persik.

Nga Lindja, ky vend laget nga ujërat e Gjirit Arab, nga veriu dhe perëndimi kufizohet me Republikën e Irakut, ndërsa nga jugu kufizohet me Mbretërinë e Arabisë Saudite.

Kuvajti ka një sipërfaqe prej 17.818 km², dhe popullsia e vendit shkon në afërsisht në 4 milion e 600 mijë banorë.^[1]

Kryeqyteti i vendit është qyteti me të njëjtin emër: Kuvajti.

Emrin, shteti e ka marrë nga fjala “keut”, që do të thotë “kala”, dhe bëhet fjalë për një fortesë që ishte ndërtuar në bregun perëndimor të Gjirit Arab, dhe që merrej si referencë për njerëzit e atyre anëve.

GJUHA DHE FEJA

Gjuha arabe është gjuha zyrtare në shtetin e Kuvajtit. Shumica e kuvajtianëve flasin arabisht, dhe dialekti i popullit të Kuvajtit është një përzierje e dialektit të rajoneve të Gadishullit Arabik dhe të zonave të Irakut, përveç pranisë së një numri të kufizuar fjalësh nga gjuha angleze dhe ajo indiane. Gjuha angleze është gjuha e huaj më e përdorur në vend, sidomos në fushën e biznesit.

Islami është feja zyrtare në Shtetin e Kuvajtit, dhe shumica e popullsisë së vendit janë muslimanë, siç gjenden gjithashtu edhe një pakicë e popullsisë që kanë besimin e krishterë.

KLIMA E KUVAJTIT

Për shkak të vendndodhjes në rajonin e shkretëtirës, Shteti i Kuvajtit ka një klimë kontinentale, ku mbizotëron moti i ngrohtë, dhe me shi radhë herë gjatë dimrit, ku temperaturat shkojnë mes 0 dhe 18 gradë Celsius. Ndërsa në stinën e verës, shfaqet klima e nxehtë dhe e thatë, që shoqërohet edhe me stuhi pluhuri. Në stinën e verës, atje temperaturat ndonjëherë arrijnë deri në 50°C; stinët e vjeshtës dhe të pranverës në Kuvajt karakterizohen nga periudhat e shkurtra kohore.^[2]

Pjesa më e madhe e sipërfaqes së Kuvajtit ka natyrë shkretinore, me vetëm disa pjesë të vogla pjellore në zonat bregdetare dhe juglindore të vendit.

Në përgjithësi, Kuvajti është një vend i shtrirë, fushor me vetëm pak kodrina jo të larta. Në zonën bregdetare vendi fillon me një lartësi në nivelin e detit, dhe vazhdon në perëndim, duke arritur deri në lartësinë 290 metra mbi nivelin e detit. Vlen të theksohet se sipërfaqja e shtetit të Kuvajtit nuk përmban asnjë sipërfaqe që mban ujë në mënyrë të vazhdueshme, siç janë lumenjtë ose liqenet, por gjenden vetëm rrjedhje lokale të ujit nëpër lugina, të cilat mbërrijnë në pellgjet e brendshme të shkretëtirës. Gjithashtu, tokës së Kuvajtit i mungojnë veçoritë e pjellorisë, pasi ajo përmban vetëm sasi të vogla të lëndëve organike.



EKONOMIA E SHTETIT TË KUVAJTIT

Shteti i Kuvajtit është një shtet mjaft i fortë ekonomikisht. Megjithatë është një vend me sipërfaqe të vogël, Kuvajti zotëron rezerva të mëdha naftë, që e vendosin atë në krye të vendeve që zotërojnë naftë. Prodhiimi i brendshëm bruto i vendit ka arritur në 165.8 miliardë dollarë amerikanë, me një normë të ardhurash individuale prej 65.800 dollarë amerikanë, në vitin 2017^[3]. Sipas këtyre shifrave, vendi renditet në vendin e pestë, në listën e vendeve më të pasura në botë.

Sektori i eksportit të naftës është burimi kryesor i ekonomisë së Kuvajtit, ku nafta eksportohet në Kinë, Japoni, Indi, Korenë e Jugut dhe Singapor. Përveç kësaj, ekonomia e Kuvajtit varet edhe nga prodhimi i plehrave dhe petrokimikëve të tjerë, sigurimi i shërbimeve financiare dhe nxjerrja e perlave nga Gjiri Persik. Qeveria vazhdimisht përpiqet për të zvogëluar varësinë nga sektori i eksportit të naftës, përmes promovimit të sektorit të tregtisë rajonale dhe të turizmit. Mallrat që më së shumti Kuvajti i importon nga jashtë

janë ushqimi, makineritë, veshmbathjet dhe produkte të tjera.^[4]

SISTEMI I QEVERISJES

Shteti i Kuvajtit sundohet nga Monarkia Kushtetuese, e kryesuar nga lideri trashëgimtar që quhet El-Emir (Princ), i cili, sipas kushtetutës, duhet të jetë një nga pasardhësit e Mubarek Ibn Es-Sabah.

Emiri (Princi) aktual i Shtetit të Kuvajtit është Shejkh Sabah El-Ahmed El-Xhabir El-Sabah.

Sistemi politik i vendit bazohet në kushtetutën që përcaktohet nga tre autoritetet: autoriteti ekzekutiv,

legjislativ dhe gjyqësor. Për Kuvajtin mund të thuhet se është një vend relativisht demokratik.

HISTORIA E LASHTË

Kërkimet arkeologjike kanë zbuluar se zona e Kuvajtit ka qenë e banuar që nga kohët e lashta. Janë gjetur gjurmë të qytetërimeve të lashta në zonën e Berkanit dhe në zonën e Sulajbikhatit, ku janë gjetur vegla dhe mjete guri si majat e heshtave, që u përkasin epokave të gurit, asaj të mesme dhe të re. Gjithashtu janë gjetur gjurmë arkeologjike edhe në ishujt kuvajtian, Felika dhe Um En-Neml, gjurmë të cilat mendohet se i përkasin qytetërimit grek helen, dhe që datojnë nga koha e Aleksandrit të Madh.^[5]

Gjatë kohërave parahistorike, zona që tani quhet Kuvajt, ka qenë si zonë e brendshme e zonave fqinje më të fuqishme përreth. Ky vend ka qenë i lidhur me Mesopotaminë qysh në epokën e Ubejdit (6.500 p.e.s), si edhe me Sumerinë (2.000 p.e.s).

Ndërkohë, mes viteve 4.000 dhe

2.000 (p.e.s), një perandori lokale e quajtur qytetërimi Dilmun, e kontrollonte gjirin e Kuvajtit, nga ku drejtonte tregtinë midis Mesopotamisë, dhe qytetërimit të Luginës së Sindit që gjendej aty ku sot është Pakistani. Pasi qytetërimi Dilmun u rrëzua (rreth vitit 600 p.e.s), Kuvajti u bë pjesë e Perandorisë Babilonase. Katërqind vjet më vonë, Grekët me në krye Aleksandrin e Madh, e kolonizuan zonën.

Në vitin 224 (e.j), Kuvajtin ra në sundimin e perandorisë sasanide të Persisë, deri në vitin 636 (e.j), kur ndodhi beteja e Zinxhirëve. Kjo betejë u zhvillua mes sasanidëve dhe muslimanëve, që komandoreshin nga Halid ibn El-Velid.

Pasi hyri nën sundimin e muslimanëve, Kuvajti u kthye sërish në një port të madh tregtar, që lidhej me rrugët tregtare të Oqeanit Indian.

EPOKA ISLAME

Beteja e Zinxhirëve që e përmendëm më sipër, ndodhi në zonën e Kuvajtit, pikërisht në vendin e quajtur Kadhima, që gjendet rreth 40 kilometra në veri-perëndim të qytetit të Kuvajtit.

Beteja u zhvillua në vitin 12 të Hixhretit (636 e.j), dhe ishte lëvizja e parë e Islamit drejt zgjerimit në Azi. Kjo betejë u zhvillua mes muslimanëve të udhëhequr nga Halid ibn El-Velid, dhe sasanidëve të komanduar nga Hermez. Beteja përfundoi me disfatën e rëndë të persianëve, gjë e cila u mundësoi muslimanëve të përparonin drejt Irakut dhe Persisë.^[6]

Në periudhën që nga fundi i shekullit të nëntë e deri në fund të shekullit 11-të, zona e Kuvajtit hyri nën sundimin e Karamitëve, që përfaqësonin një sekt Islam. Pas rënies së këtyre, vendi u shpërbë në principata lokale me natyrë fisnore, dhe kështu vazhdoi gjendja për një kohë të gjatë.

Kur portugezët patën mësyer në Oqeanin Indian, ata morën një numër portesh tregtare, përfshirë edhe gjirin e Kuvajtit, në vitin 1507.

Ndërkohë, fisi Beni Khalid, në vitin 1613, themeluan atë që sot është qyteti i Kuvajtit, që konsistonte në një seri fshatrash të vegjël peshkimi. Së shpejti, Kuvajti do të ishte jo vetëm një qendër e madhe tregtare, por edhe një vend legjendar i peshkimit dhe i zhytjes për mbledhjen e perlave. Në shekullin e 18-të, Kuvajti bënte tregti gjithashtu edhe me pjesë të ndryshme të Perandorisë Osmane, dhe u bë një qendër për ndërtimin e anijeve.^[7]

Në janar të vitit 1899, sheiku kuvajtian,

Mubaraku i Madh, bëri një marrëveshje me britanikët, sipas të cilës, Kuvajti u bë një protektorat informal britanik, dhe Britania tashmë kontrollonte politikën e jashtme të Kuvajtit. Në këmbim, Britania nuk i lejonte ndërhyrjet osmane dhe as gjermane në Kuvajt.

Pas Traktatit të vitit 1899, midis Kuvajtit dhe qeverisë britanike u nënshkruan një seri marrëveshjesh të tjera, të cilat zyrtarizuan marrëdhëniet midis dy vendeve. Shumë nga këto marrëveshje i kufizuan autoritetet e familjes Al-Sabah të sundonin të pavarur, pasi atyre nuk u lejohej t'i shfrytëzonin burimet e naftës dhe tregtinë e perlave, pa marrë miratimin paraprak nga qeveria britanike. Në vitin 1904, u emërua politikani i parë i autorizuar i Britanisë në Kuvajt, pozicioni i cili kishte një influencë të madhe në vend, dhe që zgjati deri në vitin 1961.

Në vitin 1938, në Kuvajt u zbuluan depozitat e naftës, të cilat lajmëronin për një të ardhme premtuese, por dërgesat e para të eksportit u larguan nga vendi vetëm në vitin 1946. Me zhvillimin e industrisë së naftës, shteti filloi të marrë të ardhura të larta.

Kuvajti e fitoi pavarësinë nga Britania e Madhe me 19 qershor të vitit 1961.^[8]

KUVAJTI DHE MARRËDHËNIET E TIJ ME VENDIN TONË, SHQIPËRINË

Qëkur janë hapur dyert e Shqipërisë dhe në vend erdhi demokracia, Kuvajti ka qenë ndër vendet e para që ka dhënë ndihmën e tij në të gjitha fushat për ndërtimin e jetës në Shqipëri. Shqiptarët i janë mirënjohës Kuvajtit, sidomos për mbështetjen që u ka dhënë familjeve në nevojë dhe jetimëve. Përveç kësaj, bamirësit kuvajtianë kanë financuar edhe ndërtimin e shumë xhamive në vendin tonë.

BETEJA E ZINXHIRËVE

Beteja “Dhat Es’selasil”, ose beteja e Zinxhirëve, ishte beteja e parë që u zhvillua midis muslimanëve dhe perandorisë persiane sasanide. Kjo betejë është zhvilluar në muajin Muharrem të vitit 12 hixhri (633 e.j), në zonën e quajtur Kadhime, që gjendet 40 km në veriperëndim të qytetit të Kuvajtit, brenda kufijve të shtetit të Kuvajtit.

Muthenne ibn Harithe Esh-Shejbani ishte një prijës fisnor në veri të Arabisë Lindore, që banonte në afërsi të kufirit persian. Pas luftërave të riddes (renegatëve), Muthenne i sulmoi edhe qytetet Persiane në Mesopotami. Sulmet e tij kishin qenë të suksesshme, dhe për këtë arsye, Muthenne ibn Harithe shkoi

vetë personalisht në Medine, për të informuar kalifin, Ebu Bekr Es-Sidik për suksesin e tij. Ebu Bekri e emëroi atë si komandant të popullit të tij, dhe pas kësaj, Muthenne filloi sulme më të thella në Mesopotami. Veprimet e Muthennes e bënë Ebu Bekrin të merrte vendimin të sulmonte Mesopotaminë dhe ta çlironte atë nga sasanidët. Ebu Bekri vendosi që ushtria të përbëhej tërësisht nga vullnetarë, dhe do të komandohej nga gjenerali i tij më i mirë, Halid ibn El-Velid.

Pasi kishte mposhtur profetin e vetëshpallur, Musejleme gënjeshtarin, në betejën e Jemames, Halidi gjendej akoma në zonën e Jemames. Ndërkohë, Ebu Bekri i dërgoi urdhër për të luftuar kundër perandorisë sasanide persiane.

Në javën e parë e të muajit Muharrem, të vitit 12 të Hixhretit, Halidi u nis nga Jemame, me një ushtri prej 10.000 burrash, drejt Mesopotamisë. Por, para se ta bënte këtë, ai i dërgoi një mesazh guvernatorit persian Hermuzit, ku i thoshte: “Hyr në Islam, që të jesh i sigurt, ose përndryshe pajtohu për pagimin e xhizjes, dhe kështu, ti dhe njerëzit e tu do të jeni nën mbrojtjen tonë. Nëse nuk pranon, atëherë fajëso vetëm veten tënde për pasojat, sepse po të vij me njerëz që e dëshirojnë vdekjen ashtu siç e dëshiron ti jetën.^[9]

Krerët e fiseve muslimane në zonën kufitare me Perandorinë Persiane, dhe luftëtarët e tyre (me nga 2.000 luftëtarë secila) iu bashkuan Halidit. Kështu, Halidi hyri në perandorinë persiane me 18.000 trupa.^[10]

Pas Betejës së Zinxhirëve, Halidi e mundi ushtritë persiane edhe në tri beteja të tjera, dhe e mori objektivin e tij: El-Hirah.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

1. <https://web.archive.org/web/20190507145258/https://www.paci.gov.kw/stat/>
2. <https://www.e.gov.kw/sites/kgenglish/Pages/Visitors/AboutKuwait/KuwaitAtaGlanceClimate.aspx>
3. https://www.indexmundi.com/kuwait/gdp_per_capita_ppp.html
4. <https://www.thoughtco.com/kuwait-facts-and-history-195060#history>
5. Jakub Jusuf El-Ganim “Kuvejt abr el-kurun”
6. <https://www.thoughtco.com/kuwait-facts-and-history-195060>
7. <https://www.thoughtco.com/kuwait-facts-and-history-195060>
8. <https://www.qdl.qa>
- 9, 10 - Tabariu, vëll. 2, f. 554.



Prof. dr. **Bajram XHAFA**, *historian*

HAMZA KUÇI - NJË LUFTËTAR I MADH KUR LUHEJ ME FATET E KOMBIT DHE SHTETIT SHQIPTAR

kenë mbi individualitetin, personalitetin dhe dinjitetin kombëtar shqiptar etj. Shqiptarët ende nuk e dinë mirë se ku janë, ku po shkojnë, çfarë po lënë pas si të panevojshme dhe se çfarë i pret përpara si e panjohur Me një fjalë, shqiptarët janë në një krizë të përgjithshme e të gjithanshme, që degëzohet në një mori krizash specifike në të gjitha fushat¹. Por të kthehemi tek objekti ynë!

KUSH ISHTE HAMZA KUÇI?

Hamz Kuçi, (kështu shkruhet emri i tij në dekretet me rastin e gradimeve ushtarake gjatë jetës së tij apo të emërimeve si anëtar (ushtarak) i gjykatave ushtarake të jashtëzakonshme. Lindi në qytetin e Shkodrës me 01. 04. 1891, në lagjen Dudas. Ishte njëri ndër katër djemtë e Selim Kuçit.

Vendimi Nr.23 i Këshillit të Qarkut Shkodër datë 19. 12. 2018 për t'i dhënë titullin “Nderi i Qarkut Shkodër” Hamza Kuçit (pas vdekjes) na tërheq vëmendjen për dy deduksione të rëndësishme: Së pari, Hamza Kuçi i takon plejadës së atyre burrave të Shqipërisë të cilët qëndruan në avantgardë të procesit të shtetndërtimit dhe kombformimit shqiptar. Ky vendim e nderon Këshillin e Qarkut Shkodër duke vlerësuar një figurë të anashkaluar. E dyta, që lidhet me të parën, atij i ka takuar dhe i takon (për mendimin tim) të kishte një vlerësim më të lartë në shkallë kombëtare. Por strukturat qendrore të pushtetit shtetëror shpesh janë më pak të ndjeshme ndaj figurave nacionaliste, sidomos ato që lidhen me periudhën e Pavarësisë (1912 - 1939).

Ndonjë hezitim, që mendoj se duhet të ketë patur edhe për rastin në falë, vjen për shkak të perceptimit të ndryshëm të ngjarjeve të historisë kombëtare dhe të vendit që zënë protagonistët e tyre në to. Sidomos kur është fjala për periudhën e Mbretërisë Shqiptare, ku çdo vlerësim ndryshe nga kursi “zyrtar” endë vazhdon të shihet si herezi. Kjo vjen ngase “E keqja e shqiptarëve” është shumë më e madhe se nga ç'mendohet. Në fillim të shekullit XXI, “shqiptarët ndodhen në udhëkryqin e historisë së tyre dhe nuk arrijnë dot të bien në një mendje (veç të tjerash edhe) se çfarë duan e çfarë u duhet; çfarë duhet të kërkojnë e çfarë duhet të pranojnë nga ato që u ofrohen; çfarë duhet të nderojnë e të mbrojnë dhe çfarë duhet të rishikojnë nga historia e trashëgimia e tyre; çfarë duhet të ripërtërijnë e çfarë duhet të flakin nga kujtimet, doket e huqet e tyre. nga mënyra e tyre e të jetuarit e të ëndërruarit; çfarë stereotipash duhet të braktisin e çfarë tabush duhet të krijojnë e të rrënojnë në mendimin e sjelljen e tyre politike kombëtare lidhur me miqtë e me armiqtë; çfarë përfytyrimi duhet të

Hamz Kuçi ishte njëri nga trimat shkodranë që morën pjesë në luftën për Shkodrën dhe luftuan me ashk. Kjo luftë e zuri në moshën më të bukur kur sapo kapërceu të njëzetat. Përveç kontributit ushtarak, që dëshmohej edhe nga fotografite e Marubit, ai shërbeu edhe si përkthyes personal i kryekomandantit ushtarak dhe valiut të Shkodrës, Hasan Riza Pasha. Ishte djalë i besës.

Me Luftën e Shkodrës as që mund të krahasohen luftërat e mëparshme e të më pasme nga ku kanë marrë lavdinë dhe dekoratat aq e aq emra të historisë, me vepra të kryera e të pakryera. Hamz Kuçi mori pjesë edhe në luftërat e mëvonshme, për Shkodrën, për atdheun, luftëra që historia ia rezervoi Shqipërisë martire si pjesë të pandarë të fatit të saj tragjik.

Me ardhjen e Princ Vedit më 1914, ai dërgohet për studime ushtarake në Vjenë. Në përfundim ai pajiset me diplomën e Kurseve 3 vjeçare për Oficer (1914 - 1917). Pas kthimit në atdhe, me gradën nën/toger inkuadrohet në repartet e vullnetarëve shqiptarë në kuadër të ushtrisë austro - hungareze.

Pas Kongresit të Lushnjes, Hamz Kuçi, tashmë me një përvojë e kualifikim të lartë ushtarak, do të vihet në dispozicion të qeverisë së Tiranës dhe nevojave të shtetit kombëtar shqiptar. Me gradën e togerit, bashkë me figura të tjera si Hamit Gjylbegu, Dodë Nikolla, Rexhep Shala etj, ai mori pjesë e dha kontribut të çmuar në atë që njihet si Lufta e Kopliku, në fund të korrikut 1920 kundër intervencionit ushtarak jugosllav në drejtim të Shkodrës dhe Dibrës. Ortakëria politiko - ushtarake e Italisë me.

Në vitin 1921 (korrik) Hamz Kuçi mori pjesë edhe në operacionet qeveritare për shtypjen e Kryengritjes separatiste të Mirditës të shkaktuar nga kapedani i saj Marka Gjoni, “dora e zgjatur” e Beogradit për prishjen e Shqipërisë. Në vitin 1922 Hamz Kuçi do të ishte toger i forcave të sigurisë të Komisionit Ndërkombëtar për caktimin në vend të kufijve. Më pas ai emërohet komandant i kufirit në prefekturën e Dibrës.

Nuk dua të bëj apologjinë e Hamz Kuçit, por jeta dhe vepra e tij shpreh respekt për institucionet, respekt për shtetin dhe atdheun me të cilët sot elita “nacionale” po tallet në mënyrë cinike dhe prej të cilit po e pësojnë aq shumë shqiptarët.

Për Stavro Vinjaun të luftonte Hamz Kuçi, një tjetër aventurier që, kur Vllamasi bashkë me Kolë Tromarën, Rexhep Mitrovicën dhe Beqir Valterin (ai skizofreni 17 vjeçar që i bëri atentat kryeministrit më 1924) ktheheshin nga Parisi për në Shqipëri në maj 1939, në Bari ku kishte dalë ta takonte, i thotë: “I dashur Sejfi, tetëdhjetë përqind ne e kemi marrë më qafë shtetin”⁴. Për këtë Stavër të vriteshe me vllaznit t'uaj? Apo për shokët e Riza Danit, që autori e kishte baxhanak, i cili në kulmin e dëshpërimit më tha: “Ah ç'a kemi ba na, po ta them copë se s'kemi lanë gja pa ba dhe midis shokëve të mij unë kam qenë ma ekstremisti”⁵.

Për qeverinë e Nolit, për të cilën Elez Isufi, i cili para se të bëhej viktimë haqesh, tha: Zogu s'mund të ndalet me këtë qeveri që kemi në Tiranë, por atëherë unë do të fus një bombë në tirq dhe do të hidhem në skëterrë. Për të mbajtur nderin e Nolit të griheshin sallatë shqiptarët mes vedit? Për atë Fan Nol, që kur varka e Noes së revolucionarëve të qershorit mbërrini në Brindisi i tha Gurakuqit: “Gurakuq, ne kemi bërë shumë gabime”. Dhe në shenjë pendimi, shkruan Vllamasi, Noli “rrajti mustaqet dhe mjekrën e zezë e madhështore. (oh ç'farë sakrificel!) duke thënë “Këtë borç që i pata Shqipërisë po ia laj dhe nuk e vien barra qiranë për përpjekjet për një popull njëmilionësh malarikë, por duhet të përpiqemi për popullin kinez 400 milionësh”. Një tallje prej pizevengu, jo për gabime, por për krime ndaj shtetit, popullit dhe kombit (pastaj na bën vjersha atdhetare me motive biblike). Spiro Koleka e bëri levere për këto fjalë, por Noli, aq inatçor që të shkatërronte me sarkazmën e tij e qepi gojën e nuk i ktheu përgjigje.

Me ardhjen e Zogut dhe zgjedhjen e tij në fillim si President, pastaj si “Mbret i Shqiptarëve”, Hamz Kuçi u bë për Shqipërinë tamam njeriu i duhur, në kohën e duhur e në vendin e duhur. Burrë i besës dhe i ndershëm, ai punoi me ndërgjegje të lartë e përkushtim. Përgjegjshmëria dhe vullneti u pasuan me gradimet ushtarake, të kursyera e të merituar për veprat e kryera: në shkurt 1925 u gradua kapiten i klasit II: në janar 1928 - kapiten i klasit 1: në vitin 1933 major, ndërsa më 1938, nën/kolonel.

Hamz Kuçi u emërua anëtar i Gjyqit Ushtarak në Shkodër më 15 mars 1925; anëtar i Gjyqit Politik për konspiracionin e Vlorës më 1932, anëtar ushtarak i

gjykatës së posaçme për laje politike më 17 gusht 1935 dhe më 1938 anëtar i Gjykatës së Lartë Ushtarake.

Më 1932 kryetar i Gjyqit Politik për Konspiracionin e Vlorës ishte major Bilal Nivica, anëtar kapiten Hamz Kuçi dhe kapiten Luigj Mikeli për ushtarakët, dhe dy gjyqtarë të tjerë ku gjykohehin për komplot kundër shtetit dhe terrorizëm politik: Bilal Golemi, Kostë Cekrezi, Hasan Dosti, Myqerem Hamzaraj, Qazim Kokoshi, Skender Muço, Seit Qemali, Beqir Sula, Qamil Ismail Vlora⁶. Anëtar ushtarak i gjykatës së posaçme për faje politike më 17 gusht 1935 (“Kryengritja e Fierit”) me kryetar Ali Riza Topalli - Kosova. Major Hamz Kuçi. kapiten Zel Prendushi. Për ngjarjen e fundit vijnë më shumë në apostrofë stigmat më të forta nga historiografia komuniste e krahiniste e Shqipërisë, por këto më tepër vijnë nga urrejtja për Mbretërinë dhe për Mbretin dhe s'kanë aq shumë lidhje me vetë gjykimin profesional dhe personin e Hamz Kuçil. Unë nuk kam arsye të zgjatem në motivet e gjykimit dhe vendimet e marra, profesionale apo subjektivist për pjesëtarët e kryengritjes së Fierit më 1935, një përpjekje për grusht shteti e një shëmti politike kryekëput antikombëtare, me karakter fashist e komunist së bashku, që aq shumë e qajnë komunistët e historiografisë sonë..

Dihet se, në çdo vend të botës dhe kurdoherë, ushtarakët që ngrenë krye kundër shtetit e kanë vendin në konop. Këtë gjë bëri më 1935 Musa Kranja - zv/rreth/komandant i xhandarmërisë së Fierit (që në kohën e demokracisë i përkujtuan edhe 90 a 100 vjetorin e lindjes). i cili urdhëroi xhandarët e “tij” të rrëzonin qeverinë, ashtu siç bënë dy nën/kolonelët e ushtrisë shqiptare në qershor 1924, Rexhep Shala dhe Kasem Qafëzezi, të cilët urdhëruan regjimentet e “e tyre”, njëri në Shkodër e tjetri në Përmet të marshonin drejt Tiranës për të përmbysur qeverinë e ligjshme, dalë nga zgjedhje të pranuar si të rregullta.

Pse duhet ta shkelte ligjin Hamz Kuçi në gjyqet politike e t'i falte kriminelët? Për hatër të Ali Shefqetit, ushtarak i lartë, komplotist e terrorist që mendonte të përmbyste shtetin dhe të sillte qysh më 1935 Italinë? Apo për Riza Cerovën që e nisën enkas nga B. S. për të shpërthyer revolucionin komunist në Shqipëri? Për Hekuran Manekun, i cili të vetmin “akt të lartë” moral që bëri ishte se qëllloi mbi kufomën e gjeneral Gjilardit, gjë për të

6. Owen Pearson, “Albania end King Zog” Independence. Republic and Monarchy 1908-1939. I he C'enië Ibr Albanian Studies, published 2004, f. 338.

cilën Mbreti nuk i akordoi falje këtij, që ishte i vetmi civil dhe 11 xhandarëve, si ushtarakë. Institutin e faljes e ka Mbreti, jo gjykata dhe ai e bëri atë siç duhet. Edhe në aspektin moral, historia tregoi se kush ishin këta fare burrash. Të gjithë ata që morën dënime në këto gjyqe, kur Italia pushtoi Shqipërinë në prill të 1939-s, u bënë ministra, anëtarë të Këshillit të Shtetit, jerarkë të lartë dhe morën edhe pensione prej saj⁷.

Me ardhjen e Italisë Hamz Kuçi lihet në dispozicion të Komandës së Mbrojtjes Territoriale shqiptare duke u përfshirë në funksionin e oficerëve të këmbësorisë në Shërbimin Permanent Efektiv të Ushtrisë me gradën major sipas ligjit datë 13 korrik 1939 mbi shkrirjen e forcave të armatosura shqiptare me forcat koresponduese italiane. Internohet pak kohë në Monlova (jladela të Libisë për pikëpamjet e tij antifashiste gjë që iu theksua edhe në gjyqin komunist më 1950 kur u arrestua.

Me vendosjen e regjimit komunist filloi persekutimi. Mbetet pa punë. Në vitin 1950 arrestohet dhe dënohet me 15 yjet burg për agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit. Në fund të vitit 1960 lirohet nga burgu i Burrelit dhe jeton në varfëri, pa punë, deri sa vdes në Shkodër më 19 mars 1978. (Uran Asllani, “Studentët shqiptarë të Austrisë dhe veprimtaria e tyre”, Tiranë, 2000).

Hamz Kuçi është figurë e pastër e shkodranit nationalist, personalitet me integritet moral dhe politik, koherent e me përgjegjësi të lartë, politike e morale. Në jetën e tij nuk shihet as luhata më e vogël, inkonsguencë apo zigzage politike, në fatin aq të ngatërruar të Shqipërisë sonë ku të mirë dhe të keq, ai e pret fatin e tij me gjakftohtësi e stoicizëm, ashtu siç i ka rënë për pjesë edhe vendit të tij, Shqipërisë.

Hamz Kuçi la pas dv djem: Melekun, që jetoj dhe u largua nga kjo dynja si melek. S'mund të ishte ndryshe nën diktaturën komuniste me atë hije të rëndë në biografi si nationalist dhe si mbretëror. I dyti, Selimi, i njohur si Jahuzi që aty nga viti 1962 theu kufirin, shkoi e u bë ushtar i Mbretit Leka I dhe kreu misionet të denja për një jahuz.

(Kumtesë e mbajtur në veprimtarinë organizuar me rastin e dhënies së titullit “Nderi i Qarkut Shkodër” nga Këshilli i Qarkut Shkodër Hamza Kuçit)

7. Mentar Belegu, Kryengritja antizogiste e Fierit, Tiranë, 1987.

NË XHAMINË E KOSMAÇIT KËNDOHET MEVLUDI SHERIF

Ditën e shtunë, më 4 janar 2020, në xhaminë e Kosmaçit u zhvillua aktiviteti i këndimit të Mevludit Sherif, në përkujtim të Resulull-llahit, Profeti i fundit Muhamedi a.s.

Krahas shumë besimtarëve të fshatit Kosmaçë dhe fshatrave të tjera të zonës së Bushatit, merrnin pjesë edhe imami i xhamisë së Shkjezit, Dritan Cukali, imami i xhamisë Ganjollë, Erion Hasmeqaj, hoxhallarë etj.

Imami i xhamisë Kosmaçë, Bujar Hoxhani në fjalën e tij përshëndetëse foli përmbledhurazi për jetën dhe veprën e ndritur të Dërguarit të Allahut xh.sh, për mesazhet udhëzuese dhe mëshiruese, për të cilat u dërgua për mbarë njerëzimin.

Në vijim të programit kënduesit e Mevludit, Vullnet Pishtari, Qamil Ujka dhe Elsamet Tula përcollën para të pranishmëve pjesë nga Mevludi Sherif, Salavate, Dua-hatme, ilahi etj.



KËSHILLI I MYFTINISË DISKUTOI MBI AKTIVITETET E VITIT JUBILAR 2020

Pasditën e së mërkurës, më 8 janar 2020, ashtu siç ishte planifikuar më parë, Këshilli i Myftinisë Shkodër zhvilloi mbledhjen e radhës, ku në qendër të vëmendjes ishin diskutimet mbi aktivitetet e vitit jubilar 2020, që përkon me 30 vjetorin e lirisë së besimit, pas periudhës 23 vjeçare të ndalimit të lirisë së besimit me ligj në Shqipëri.

Në krye të herës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari theksoi se 30 vjetori i rihapjes së xhamisë së parë, pas një periudhe të gjatë femohimi dhe ndalimi me ligj të fesë në vendin tonë, është në vetvete një moment reflektimi për të parë se çfarë kanë qenë këto 30 vjet për aktivitetin e Myftinisë Shkodër dhe muslimanëve në kryeqendrën veriore të vendit tonë.

Njëkohësisht dha disa mendime që lidhen me detajet e aktivitetit të këtij viti për Myftininë e Shkodrës me krejt kuadrot e saj.

Mendime me vlerë dhanë edhe këshilltarët, ku sekretari i Këshillit të Myftinisë Shkodër, H. Fejzi Zaganjori paraqiti me shkrim mendimet dhe propozimet e tij të dobishme, në mënyrë



që ky vit të dëshmohet për gjallërinë e aktiviteteve në nder të këtij viti jubilar.

Po ashtu, drejtori i Medresës "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi, i cili dha mendimet e tij, që lidhen edhe me bashkëpunimin e Myftinisë me institucionet e tjera serioze të qytetit dhe jashtë tij, që kjo atmosferë të dëshmohet sa më mirë.

Këshilltari Admir Admir V. Temja, kërkoj që rrjeti i bashkëpunësorëve të zgjerohet, që mesazhet e këtij viti të kenë një jehonë sa më të madhe.

Nga ana e tij, teologu Lavdrim Hamja, diskutoi mbi mundësinë e realizimit të disa aktiviteteve risi, zhvillimi i të cilëve do t'i jepte një kuptim edhe më të plotë kësaj iniciative të re.

Mendime me vlerë dha edhe këshilltari Jetmir Braqi, i cili diskutoi mbi mundësinë e zhvillimit të një cikli ligjëratash e takimesh me rininë e fshatrave, që kanë shumë nevojë të dinë për fenë e besimin në përballjen e tyre me sfidat e ateizmit, propagandës islamofobe, etj.

MYFTINIA SHKODËR MORI PJESË NË CEREMONINË E 107 VJETORIT TË KRIJIMIT TË POLICISË SË SHTETIT SHQIPTAR

Të hënë, më 13 janar 2020, në ambientet e Policisë Vendore të Shkodrës u zhvillua ceremonia përkujtimore e 107 vjetorit të krijimit të Policisë së Shtetit Shqiptar.

Krahas drejtuesve të lartë nga policia, prefektura, bashkia, prokuroria, gjykata, familjarë të policëve të rënë në krye të detyrës, etj, merrnin pjesë edhe autoritete të komuniteteve fetare të qytetit. Në këtë ceremoni Myftinia Shkodër u përfaqësua nga H. Fejzi Zaganjori



dhe teologu Arben Halluni.

Pas himnit kombëtar, përshëndetjeve të rastit nga personalitete të policisë vendore dhe kryetares së bashkisë, përfaqësuesit e dy komuniteteve fetare, H. Fejzi Zaganjori dhe At. Nikolla Petani bënë një lutje të përbashkët për mbarësi e suksese policisë së shtetit gjatë misionit të tyre fisnik si dhe u lutën për shpirtat e policëve dëshmorë, të rënë në krye të detyrës.

MYFTIU LIGJËROI NË XHAMINË E GUCISË SË RE

Pas akshamit të së shtunës, më 18 janar 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti një ligjëratë në xhaminë e fshatit Guci e Re.

Fillimisht, Myftiu falënderoi imamin e kësaj xhamie, këshillin e xhamisë dhe imamin e saj, z. Bledar Kodra, për përkujdesjen e vazhdueshme ndaj kësaj xhamie dhe tërheqjen e rinisë, që janë pjesë e pandarë e xhamive tona.

Në ligjëratën e tij, Myftiu u ndal tek shfrytëzimi i kohës për të arritur qëllimet e larta në jetë. Ai iu drejtua të rinjve të pranishëm që të vlerësojnë çdo moment të jetës për të dëshmuar në mënyrën më të bukur besimin e dhe Islamin e tyre, duke spikatur në çdo fushë të jetës.

Myftiu solli në vëmendje të besimtarëve ajete dhe hadithe që nxisin shfrytëzimin e kohës dhe mbi të gjitha madhërimin e saj, duke e konkretizuar



me shembuj nga jeta e njerëzve të suksesshëm, që kanë arritur majat e

shoqërisë, falë besimit, vullnetit dhe respektimit të kohës.

MYFTIU VIZITOI KRYETAREN E BASHKISË SHKODËR



Paraditën e së hënës, më 20 janar 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë në Bashkinë e Shkodrës, ku u prit nga Kryetarja e Bashkisë, znj. Voltana Ademi.

Pas urimeve të rastit për një vit sa më të mbarë e me bekime për Shkodrën dhe qytetarët e saj, Myftiu theksoi se është me vlerë për krejt komunitetin që njerëzit të respektojnë institucionet dhe të kenë besim tek to.

Ai tha se ka shumë rëndësi që njerëzit të mos e humbin shpresën dhe optimizmin, përballë realiteteve, që hera-hera duan t'ia zënë frymën qytetit e vendit.



Vizita e sotme kishte një vlerë të veçantë sepse përkon me turin e vizitave dhe takime që Myftiu i Shkodrës ka planifikuar me rastin e vitit jubilar të 30 vjetorit të rilejimit të fesë me ligj në Shqipëri.

Në këtë takim u diskutua edhe për zhvillimin e aktivitete të përbashkëta me Bashkinë e Shkodrës, në atmosferën e këtij jubileu të rëndësishëm për Myftininë e Shkodrës dhe krejt qytetin.

Gjatë takimit u diskutua edhe për disa çështje me interes të përbashkët, për të cilat palët ranë dakord.

Në përfundim, Kryetarja e Bashkisë dhe Myftiu dhanë edhe intervistën e rastit për mediat e pranishme.

FRYMËMARRJE E RE PËR NJË VAKËF TË NËPËRKËMBUR!..

Pas vitesh të shumta përpjekjesh dhe angazhimi për rikthimin në identitet të vakëfeve tona të shenjtë, trashëgim i burrave fisnikë muslimanë të Shkodrës, sot, ditën e xhuma, më 24 janar 2020, nisi aksioni për pastrimin e një pjese të vakëfit të grabitur në zonën Zdralej.

Aksioni i sotëm është me rëndësi për Myftininë e Shkodrës, sepse lirohet një truall legjitim i institucionit të muslimanëve të qytetit tonë (edhe të atyre, që mundohen të fshihen pas emrave të nderuar të gjyshërve fisnikë, edhe pse vetë nuk i gëzojnë këto dy cilësi, teksa pretendojnë se zhvatja e tyre ndaj vakëfit është në të vërtetë shfrytëzim i tokës së lënë të gjyshërve! Sa turp për atë taban!), pavarësisht pengesave të shumta dhe ndërhyrjeve politike, por jo vetëm, për këtë dhe përtej këtij vakëfi!

Myftinia Shkodër nuk hoqi dorë nga kjo e drejtë legjitime, pavarësisht se kohëve të fundit media të caktuara kombëtare, vizive dhe të shkruara, por jo vetëm, nuk lanë gurë pa luajtur për të mbrojtur një zullum të madh, që qëndronte si një njollë turpi në një tokë, që kush nuk u përpoq për ta bërë të veten, e kush nuk u përpoq të fitonte qoftë edhe dy qindarka më shumë haram!

Por, jeta nuk ka begati me haram e mashtrim, me shitje të dinjitetit e izolim të ndërgjegjes, për të futur në dorë atë që është e huaja!

Në fakt, ky fenomen, sa vjen e merr formë të frikshme në Shkodër e Shqipëri, ku dita-ditës maska të shumta po bien dhe përherë e më tepër po shfaqen tiparet e fajdes, zhvatjes, grabitjes e mashtrimit në jetën e njerëzve!

O njerëz, hiqni dorë nga harami dhe pendohuni tek Zoti juaj, se e ardhmja nuk ndryshon, veçse mbi bazat e paqimit me Zotin e gjithësisë dhe afrimin me udhëzimin e tij!

Sot, janë me dhjetëra dosjet e pronave vakëf të shkelura padrejtësisht, mbi të cilat rëndojnë edhe 30 vite pas katrahurës së vitit të errët 1967!? Nuk e kishim ditur se demokracia do na sillte një zhvatje të re të pronave tona legjitime, edhe më dinake e më zullumqare se zia komuniste, atë të legalizimit!?

Pra, shumë prona që na i mori me dhunë sistemi komunist, na i zhvati rishtazi sistemi i ri i pas vitit 1990!

A është e denjë për një vend të vogël si Shqipëria, të ketë kaq shumë zullume, shkelje e mashtrime, korrupsion e mungesë të frikës së Zotit në zemrat e njerëzve?

Qoftë e hajrit dhe u pasoftë me pastrimin e shumë vakëfeve të tjera të uzurpuara, por edhe të keqmenaxhuara gjatë këtyre tri dekadave aktivitet të Myftinisë, pas ndryshimit të vitit 1990!

Imam Muhamed B. Sytari

*Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 24 janar 2020*



MEJTEPI I IM... XHAMIA KRYE-BUSHAT

PAK HISTORI:

- Xhamia Krye-Bushat, ndodhet në Njësinë Administrative Bushat.

- Përbëhet prej rreth 235 familje. Fiset më të mëdha në Bushat janë: Mustafa, Çelepija, Shimaj, Pervizi dhe Muçejane.

- Xhamia e re Krye-Bushat ka filluar funksionin e saj në vitin 2017.

- Në këtë zonë është edhe xhamia tjetër, e para në qendër të Bushatit, e hapur me kërkesë të banorëve, të kryesuar nga kryetari i këshillit të xhamisë, z. Zyhdi Mustafa, qysh në fillim të rihapjes së besimit, rreth vitit 1991, pikërisht pas rihapjes së xhamisë së Plumbit.

Afër kësaj xhamie është edhe një qendër-konvikt nën administrimin e shoqatës së Vakfit Islamik Shqiptaro-Turk, e cila merret me mësimin dhe



TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në vijim të vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi takimin e radhës me nxënësit e kursit fetarë të xhamisë Krye-Bushat.

Në fillim, teologu Halluni mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përcimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë secilin në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi i arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesit e nderuar hafiz Shukri Kapllan dhe ndihmësin e tij, z. Ervis Molla, të cilët me përkushtim të vazhdueshëm mirëmbajnë këto veprimtari mjaft të rëndësishme edukative dhe arsimore në një zonë me tradita fetare-atdhetare dhe që brez pas brezi ruajnë e zhvillojnë më tej harmoninë dhe bashkëjetesën ndërfetare.

Gjatë këtij aktiviteti u zhvillu edhe një konkurs fetar, ku në të u bënë pjesë edhe një grup i nxënësve të kursit fetar të xhamisë Shkëzë të shoqëruar nga mësuesi i tyre, Dritan Cukali.

Aktiviteti u mbyll me zhvillimin e disa lojërave sportive.



edukimin e nxënësve, ku disa prej tyre vazhdojnë studimet për imam-hatib në Turqi dhe më pas shërbejnë si hoxhallarë në vende të ndryshme të Ballkanit, si në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut etj.

- Në këto dy xhami nga viti 1991 deri më sot kanë shërbyer imam dhe mësues të mejtepeve: Fahrettin Ipek, Muhamed Ali, Osman Kashirik, Ervis Molla dhe imami e mësuesi i mësim-besimit aktual, hafiz Shukri Kapllan.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 18 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami, në periudha të ndryshme nga viti 2002 - 2020 është rreth 260 nxënës dhe nxënës.



NAMAZI I PEDALISTIT...

Milano, një namaz, një rreze drite në errësirë.

Në Milano, në një ditë si gjithë të tjerat, një djalë me biçikletë, një pedalist i përkushtuar për të shpërndarë pica apo pako postare klientëve të ndryshëm për disa euro bakshish ora.



Trafik, mjegull, zhurme, asgjë më të largët sesa qetësia, sesa përshtetësia drejt të cilës synon shpirti njerëzor.

Gjithnjë duke garuar për të fituar diçka më tepër në rrjedhën e një qyteti, që është gjithnjë në lëvizje, duke i shtuar kësaj edhe vetminë.

Është një nga fytyrat e reja e të tjetërsuara dhe të neoliberalizmit, që heq frymën e njerëzve duke i marr kohen dhe një pjese të jetës.

Por, papritmas i riu ndalet, heq çantën e shpinës dhe këpucët, shtron tapetin e vogël dhe zë një qoshe duke u mbrojtur nga vështirimet kureshtare dhe nga zhurmat për pesë minutat e parajsës së tij të përditshme, që përsëriten nga pesë herë në ditë, në çdo ditë të vitit.

“Duke ndërtuar kopshtin e tij kudo që të jetë. Ai djalosh nuk është thjesht vetëm një punëtor, ai është një musliman dhe po kryen një nga 5 namazet”.

Ky imazh, që copëton rutinën e përditshme të jetës së tjetërsimit, duke iu përgjigjur një dëshirë të thellë të shpirtit njerëzor, atë të veçimit me Krijuesin.

Diçka e ngulur thellë në natyrën njerëzore, diçka që të cilën për ta varrosur, padronëve të shekullit do t’u duheshin shekuj dhe vite e vite kushtesh sociale, dhe në të shumtën e rasteve ata as nuk ia arrijnë të kenë sukses.

Dhe në këto momente, ai djalosh besimtar është aty duke u falur, bëhet fjale për akt sublim.

Përktheu nga italishtja:

Ervil Kuçi

NË UNIVERSITETIN E PARMËS FALET XHUMAJA E PARË

Në qytetin e Parmës, Itali, u shkrua një pjesë e vogël e historisë, pikërisht në vitin që qyteti do të jetë kryeqyteti i kulturës. U zhvillua hytbeja e parë (ligjërata e ditës së xhuma), në Universitetin e themeluar në vitin 962, një nga më të vjetrit në botë.

Disa vite më parë Sara Mahfud, së bashku me disa studentë të tjerë themeluan ASMU – Shoqatën e Studentëve Muslimanë, që edhe bënë kërkesë për të pasur një hapësirë për kryerjen e faljes. Kërkesa u pranua dhe u dha një hapësirë e rezervuar, vetëm për muslimanët, ndonjë tapet, ndonjë libër, pra me pak fjalë, një xhami e vogël universitare.

Vitet kaluan, studentët shkuan e erdhën, regjistrime të reja dhe të diplomuar të rinj., pastaj zgjedhja e Sara Benchouchane, e cila më kërkoi nëse është e mundur që të zhvillohet hytbeja e ditës së xhuma, me datë 17 janar 2020. Prej disa muajsh mbaj hutben në dy xhami të qytetit të Parmës, ose bëj përkthimin e hytbes nga gjuha arabe në italisht, pasi jo të gjithë pjesëmarrësit në xhami janë arabë.

Dita e xhuma e datës 17, kështu ishte

dita e madhe, ndërkohë nisem drejt universitetit dhe gjej dy vajza që po prisnin, fillojnë duke ardhur pak nga pak vajza të tjera dhe më në fund edhe ndonjë djalë.

Së fundmi, u bëmë gati afërsisht 20 persona. Djemtë ulen përpara, ndërsa vajzat mbrapa, pa asnjë ndarje midis nesh, kështu dal përpara të gjithëve dhe fillon riti i xhumasë.

Një diskutim tepër i thjeshtë mbi rëndësinë e të qenurit musliman aktiv në shoqëri, duke filluar nga gjërat e thjeshta, mbi vlerën e sallës së faljes në universitet dhe sesi ne në atë vend, ata pak persona që ishim në atë sallë të vogël, po shkruanim historinë!

Emocionet na preken në zemër dhe të gjithë ne kishim sytë e mbushur me lot emocionesh. Në fund të hytbes, lutja për mbarrëvajtjen e sezonit të provimeve, mua më dukej mëse e drejtë, dhe pas saj falja e xhumasë.

Të gjithë kërkuar që hytbeja të zhvillohej çdo të xhuma dhe tani shoqata ASMU përgatitet për një sfidë të re.

Muhamed E. Attarki

Përktheu nga italishtja:
Ervil Kuçi

HIXHABI APROVOHET SI PJESË E UNIFORMËS NË POLICINË E SKOCISË

Policia skoceze ka përfshirë mbulesën e shamisë (hixhabin) në mesin e opsioneve zyrtare të uniformës, transmeton Anadolu Agency (AA).

Në një deklaratë me shkrim nga policia skoceze thuhet se vendimi është marrë me qëllimin për të “inkurajuar gratë nga komuniteti musliman ta rimendojnë këtë çështje, pasi ato më parë nuk e shikonin si një alternativë karriere për t’u bërë police”.

Në deklaratë theksohet se ky vendim do të sigurojë që policia të përfaqësojë më mirë shtresat e ndryshme në komunitet.

Pavarësisht se mbulesa e shamisë ndodhet në mesin e opsioneve të policisë angleze që nga viti 2001, përdorimi i hixhabit për policet në Skoci ishte i lidhur me lejen e drejtuesve.

Ishte zbuluar se vetëm 127 nga 4.809



personat që aplikuan vitin e kaluar për t’u bërë polic në Skoci i përkisnin një komuniteti të ndryshëm etnik ose fetar.

Është e nevojshme që ky numër të rritet në 650, në mënyrë që kjo të jetë në përputhje me proporcionin e grupeve etnike ose fetare në të gjithë vendin.

Muslimanët përbëjnë rreth 3 milionë e 500 mijë banorë të popullsisë mbi 66 milionë të Mbretërisë së Bashkuar e cila përbëhet nga Anglia, Uells, Skocia dhe Irlanda Veriore.

(www.radiojehona.al)

NJIHUNI ME SHKENCËTARIN MUSLIMAN AL-QALASADI, PA TË CILIN MATEMATIKA DO TË ISHTE E PAVLERË

Në ditët e sotme ne nuk mund të imagjinojmë algjebërën pa simbole, por ka qenë një kohë kur zbulimi i disa prej këtyre simboleve në botën e matematikës ishte një përparim i madh. Personi që ndërmori një nga hapat më të rëndësishëm përpara në këtë drejtim ishte matematikani musliman andaluzian Abū’l Hasan ibn Al-Qalasadi.

Qalasadi lindi në 1412 në Baza, një qytet i vogël afër Granadës, fortessa e famshme myslimane në Spanjën e Jugut. Ai studioi disiplinat islamike në qytetin e tij të lindjes deri në moshën 24 vjeç, dhe më pas udhëtoi nëpër Afrikën e Veriut për 15 vjet për të studiuar dhe diskutuar tema të ndryshme me shumë njerëz të arsimuar që takoi gjatë rrugës. Më i famshmi nga këta ishte ndoshta studiuesi Ibn Hajar al-Asqal të cilin Qalasadi u takua për pak kohë kur ishte në Egjipt. Ai u kthye më pas në Spanjë, duke u vendosur në Granada, ku vazhdoi të studioje dhe ku u përqendrua veçanërisht në matematikë, ligj dhe filozofi.

Qalasadi është i njohur për punën e tij në matematikë, posaçërisht për një temë në të cilën ai shkroi të paktën 11 vepra madhore. Më e rëndësishmja nga këto ishte Tafsīr fi’l-Ilm al-Hisāb (Komenti i Shkencës së Aritmetikës). Në të, Qalasadi prezantoi simbole të reja algjebrike, duke lëvizur përtej shënimeve të thjeshta që matematikanët e mëparshëm si Diophantus (Greqi) dhe Brahmagupta (Indi) kishin krijuar.

Është e rëndësishme të kuptohet se kontributi i veçantë i Qalasadi nuk ishte se ai ishte i pari që prezantoi simbole të reja ose i pari që zhvilloi një sistem shënimesh në algjebër, por që ai ishte i pari që njihet se i bëri të dyja këto në të njëjtën kohë.

Ai përdori një simbol të ngjashëm me J si një shenjë të barabartë dhe përdori ekuivalentin arab të “m” për vlerat katror

si x2 (dhe ekuivalentin arab të K për vlerat kub si x3).

Ai standardizoi përdorimin e termave arabë “ëa” për shtesë, “illā” për zbritje, “fi” për shumëzimin dhe “alā” për ndarje.

Ai gjithashtu thuhet se ka qenë i pari që ka ndarë numëruesin dhe emëruesin e një fraksioni me një rresht dhe ka arritur të bëjë dallimin midis fraksioneve të përbashkëta dhe atyre të ndara. Të gjitha këto kontribute janë thelbësore për të kuptuarit dhe përdorimin e matematikës sot.

Ai gjithashtu shkroi nëntë libra për gramatikën dhe gjuhën dhe 11 për juridiksionin dhe traditat e Profetit Muhammed.

Një nga studentët e Qalasadi, Abū Abd Allāh al-Sanūsī, autori i 26 librave mbi matematikën dhe astronominë, disa prej të cilave u njohën si tekste autoritative në të gjithë Afrikën e Veriut.

Por historia e Qalasadi përfundon në një shënim të trishtuar pasi ne mund ta konsiderojmë atë matematikanin e fundit të madh mysliman të al-Andalus. Në 1492, gjashtë vjet pas vdekjes së Qalasadi, Granada, qyteti i fundit mysliman në Spanjë, ra në forcat e krishtera të Ferdinand dhe Isabellas. Një vit më pas, Arqipeshkvi Cisneros urdhëroi shndërrimin e detyruar të muslimanëve dhe hebrenjve në krishterim dhe urdhëroi djegien e dorëshkrimeve të tyre të vlerësuar, përfshirë shkrime të tilla si ato të Qalasadi.

Për fat të mirë, puna dhe idetë e Qalasadi mbijetuan dhe vazhduan të përdoren për shekuj; në autobiografinë e tij, studiuesi maroken, Muhamed Da’d shkroi se në vitin 1920 babai i tij do ta mësonte atë matematikë nga “libri i al-Qalasadi”. Puna e tij themelore gjeti rrugën drejt Evropës, ku luajti një rol të rëndësishëm në prapaskenat e Renesansës në Evropë.

(www.mesazhi.com)



A E DINI SE STAMBOLLI ËSHTË NJË PREJ QYTETEVE MË TË LASHTA NË BOTË?



Stambolli, i vetmi vend në botë që ka tokë në dy kontinente, ndodhet edhe në kontinentin e Evropës, edhe në kontinentin e Azisë. Stambolli ka qenë kryeqytet i qytetërimeve (civilizimeve) të shumta si ai romak, latin, bizantin dhe osman si dhe një prej qyteteve më të vjetra të botës.

Stambolli është qyteti më i populluar i Turqisë dhe një prej 5 qyteteve më të populluara në botë. Me një popullsi prej 15 milionë banorësh lë pas shumë vende si Belgjika, Greqia, Tunizia, Portugalia, etj. Por kjo nuk është e kufizuar me shekullin e fundit.

Stambolli edhe në vitet 1500 ishte një ndër qytetet më të populluara në botë. Krahas faktit se është një ndër qytetet turistike me zhvillimin më të shpejtë, Stambolli mbart edhe veçorinë e një prej qendrave tregtare me zhvillimin më të shpejtë.

Për qytetin e Stambollit ekzistojnë shumë legjenda urbanistike. Një prej tyre ka të bëjë me Bririn e Artë (Haliç)... Sipas gojëdhënave, fundi i Haliçit është plot me flori dhe në kohët, japonezët, vetëm e vetëm që të merrnin florinjët, kërkuar të pastrojnë falas Bririn e Artë. Mbase për këtë arsye fjala “Guri e toka e Stambollit është prej floriri”, që filloi të qarkullojë gjatë migrimeve të mëdha në këtë qytet në vitet 1950, e ka prejardhjen pikërisht nga kjo gojëdhënë.

(www.trt.net.tr/shqip)



ABONIMET NË SHTYPIN ISLAM PËR VITIN 2020



**1 VIT
ABONIM**

- **Zani i Naltë 800 lekë**
- **Drita Islame 1200 lekë**
- **Udhë Islame 500 lekë**

Adresa:
Pranë Myftinisë Shkodër

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org